


deg  
18.12.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

87

**V E N D I M**

Nr. 1008, datë 16.12.2015

**P Ë R**

**MIRATIMIN E PROFILIT KOMBËTAR TË ZGJERUAR**  
**TË MIGRACIONIT, PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 141, të ligjit nr.108/2013, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Profilit Kombëtar të Zgjeruar të Migracionit, për vitin 2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Instituti i Statistikave për botimin e këtij profili në faqet zyrtare të institucioneve në internet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**MINISTRI I PUNËVE  
TË BRENDSHME**

**SAIMIR TAHIRI**

# **Profili Kombëtar i Zgjeruar i Migracionit, për vitin 2014**

**Republika e Shqipërisë**

**Tiranë 2015**

Ky dokument prezanton Profilin e Zgjeruar të Migracionit në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2012-2014. Hartimi dhe publikimi i tij është mbështetur në piken 4, të nenit 141, të Ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt". Informacioni i mbledhur dhe analiza e të dhënave për përgatitjen e këtij Profili është siguruar nga burime zyrtare. Profili i Zgjeruar i Migracionit, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Ministrave si dhe të institucioneve përgjegjëse për hartimin e tij. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Grupit të Punës, të ngritur me Urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme, nr. 80, datë 23.02.2015. Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo transmetohet në asnjë formë apo mënyrë elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjen, regjistrimin pa të drejtën e autorëve. Materiali është publikuar me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin.

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Profili i Zgjeruar i Migracionit 2014



Ministria e Punëve të Brendshme



Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë



Ministria e Punëve të Jashtme



Ministria e Financës



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,  
Tregtisë dhe Sipërmarrjes



Instituti i Statistikës



Ministria e Arsimit dhe e Sportit



Ministria e Shëndetësisë



Banka e Shqipërisë



Qendra Kombëtare e Regjistrimit



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

## **PËRMBAJTJA**

Hyrje dhe mirënjohje

Lista e tabelave

Lista e figurave

Lista e shkurtimeve

## **INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

#### **A. SITUATA DHE PRIRJET MIGRATORE**

##### **A.1. Emigrimi i shtetasve shqiptarë**

###### **A.1.1. Stock-u migrator në raport me popullsinë**

###### **A.1.2. Flukset migratore bashkëkohore**

###### **A.1.3. Disa karakteristika aktuale të emigrimit të shtetasve shqiptarë**

###### **A.1.4. Fluksi i azilkërkuesve, shtetas shqiptarë në vendet e BE-së**

###### **A.1.5. Veçori të formimit dhe zhvillimit të Diasporës së Shqipërisë**

###### **A.1.6. Përbërja e Diasporës së Shqipërisë**

###### **A.1.7. Harta e emigrimit të shtetasve shqiptarëve**

###### **A.1.8. Faktorët shtytës dhe tërheqës të emigrimit të shtetasve shqiptarë**

###### **A.1.9. Kanalet e emigrimit të shtetasve shqiptarë në periudhën 2012-2014**

###### **A.1.10. Dinamika e legalizimit të emigrantëve shqiptarë në periudhën 2012-2014**

###### **A.1.11. Migrimi i brendshëm si “trampolinë” për migrimin e jashtëm**

###### **A.1.12. Intensifikimi i kthimit të emigrantëve shqiptarë gjatë viteve 2012-2014**

###### **A.1.13. Shërbimet e Sporteleve të Migracionit ndaj emigrantëve të kthyer, 2012-2014**

###### **A.1.14. Rritja e lehtë e dërgesave në para të emigrantëve**

##### **A.2. Imigrimi drejt Shqipërisë**

###### **A.2.1. Shqipëria si vend pritës**

###### **A.2.1.1. Imigrantët e rregullt rezidentë në Shqipëri, 2012-2014**

###### **A.2.1.2. Studentët e huaj në universitetet shqiptare, 2012-2014**

###### **A.2.1.3. Trajtimi i azilkërkuesve, 2011-2014**

###### **A.2.1.4. Natyralizimi i shtetasve të huaj në Shqipëri**

###### **A.2.2. Shqipëria si vend tranzit**

## **B. NDIKIMI I MIGRIMIT NË EKONOMINË DHE SHOQËRINË SHQIPTARE**

### **B.1. Migrimi dhe zhvillimi demografik**

#### **B.1.1. Popullsia e Shqipërisë**

#### **B.1.2. Migrimi i jashtëm në pakësimin e moderuar të popullsisë**

#### **B.1.3. Ndikimi i koeficientit të migrimit neto në popullsinë e Shqipërisë**

#### **B.1.4. Ndikimi i strukturës së flukseve migratore në zhvillimet e popullsisë**

#### **B.1.5. Ndikimi i emigrimit në raportet e varësisë moshore dhe në strukturën e popullsisë**

### **B.2. Korrelacioni midis emigrimit dhe zhvillimit ekonomik**

#### **B.2.1. Zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik**

#### **B.2.2. Investimet e Huaja**

##### **B.2.2.1. Investimet e Huaja sipas shteteve**

##### **B.2.2.2. Investimet e Huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik**

##### **B.2.2.3. Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte**

##### **B.2.2.4. Investimet e Huaja Direkte dhe punësimi**

#### **B.2.3. Rritja ekonomike, mirëqenia dhe flukset migratore**

### **B.3. Migrimi dhe zhvillimi i tregut të punës**

#### **B.3.1. Tregu atipik i punës si ushqyes i flukseve migratore**

#### **B.3.2. Tiparet e tregut të punës dhe flukset migratore**

#### **B.3.3. Informaliteti në tregun e punës**

#### **B.3.4. Ndikimi i punësimit të të huajve në tregun e punës**

### **B.4. Migracioni dhe shëndeti**

## **C. KUADRI PËR MENAXHIMIN E MIGRACIONIT**

### **C.1. Kuadri ligjor**

#### **C.1.1. Politikat migratore të shprehura në normativën migratore**

#### **C.1.2. Ndryshimet në normativat migratore europiane**

#### **C.1.3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe instrumentat ndërkombëtare**

#### **C.1.4. Përmirësimi i legjislacionit kombëtar mbi migracionin**

#### **C.1.5. Akte dy apo shumë paëshe të njohura nga Republika e Shqipërisë**

### **C.2. Kuadri institucional**

#### **C.2.1. Niveli qeveritar**

#### **C.2.2. Niveli institucional**

##### **C.2.2.1. Ministria e Punëve të Brendshme**

##### **C.2.2.2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

##### **C.2.2.3. Ministria e Punëve të Jashtme**

C.2.24. Ministria e Shëndetësisë

C.2.25. Ministria e Arsimit dhe Sporteve

C.2.26. Instituti i Statistikave

C.2.27. Aktorë të tjerë institucionalë në fushën e migracionit

C.3. Kuadri i politikave

C.3.1. Politikat migratore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

C.3.2. Politikat migratore të Ministrisë së Punëve të Brendshme

C.3.3. Politikat migratore të Ministrisë së Punëve të Jashtme

## **D. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

D.1. Përfundime

D.2. Rekomandime

D.2.1. Rekomandime për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e sistemit të mirëqenies si kusht për dekurajimin e flukseve migratore.

D.2.2. Rekomandimet për përfshirjen e migracionit në politikat sektoriale dhe ndërsektoriale

D.2.3. Rekomandimet për përmirësimin e statistikave migratore si bazë për hartimin e politikave

## **E. ANEKSE**

Aneksi 1 Tabela statistikore

Aneksi 2 Figura ilustruese

## HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Ky raport analitik paraqet një vazhdimësi të procesit të filluar në vitin 2007 nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM) për hartimin e Profilit të parë për Migracionin, për të vijuar më pas me Profilet e Migracionit për vitet 2008, 2009 dhe 2010 të hartuara nga Qeveria Shqiptare. Pas një vakumi 2 vjeçar, në vitin 2013 u hartua Profili i parë i Zgjeruar për Migracionin<sup>1</sup> në zbatim të dispozitave ligjore të Ligjit 108/2013 “Për të Huajt”. Profili aktual është hartuar sipas një modeli më të avancuar dhe nga një grup pune ndërinstitutional nën drejtimin e Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin (DPKM) në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) që bashkëpunoi dhe me organizma të tjera qeveritare dhe joqeveritare kontribuese në fushën e migracionit në Shqipëri. Në këtë kontekst, shprehim mirënjohje për të gjithë anëtarët dhe vëzhguesit e Grupit të Punës, për pjesëmarrjen e tyre aktive dhe kontributin e vlefshëm.

Një falenderim i veçantë shkon për ekspertët e ONM për mbështetjen në thellimin e analizave në raport, plotësimin e të dhënave, dhe përputhjen më të plotë të strukturës së tij me standartet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë veprimtari, si edhe me kërkesat ndërkombëtare për hartimin dhe botimin e profileve të migracionit.

---

<sup>1</sup> Ky Profil u miratua me VKM nr 857, datë 10.12.2014



## Listae tabelave

Tabela 1.1.	Numri i shtetasve shqiptarë të kapur në vendet e BE
Tabela 1.2.	Shtetas shqiptarë të kthyer sipas grup moshave dhe gjinisë për 2011- 2014
Tabela 1.3.	Shtetet kryesore kthyesë të të miturve të pashoqëruar
Tabela 1.4.	Kthimi i të miturve nga vendet e BE me procedurë ripranimi
Tabela 1.5.	Kthimi i të miturve nga vendet e BE me procedurë ripranimi
Tabela 1.6.	Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM sipas shkakut të kthimit, vitet 2012, 2013, 2014
Tabela 1.7.	Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM sipas grup-moshave për vitet 2012, 2013, 2014.
Tabela 1.8.	Shtetasit shqiptarë të kthyer sipas shërbimeve të përfituara në SM në vitet 2012, 2013, 2014
Tabela 1.9.	Riintegrimi arsimor i emigrantëve të kthyer , 2014
Tabela 1.10.	Të huaj rezidentë në Shqipëri sipas shtetësisë
Tabela 1.11.	Të huaj që studiojnë në Shqipëri, 4 shtetësitë kryesore
Tabela 1.12.	Të huaj azilkërkues sipas shtetësisë
Tabela 1.13.	Vendime pezullimi sipas shtetësisë
Tabela 1.14.	Aplikime për marrjen e shtetësisë shqiptare, 2012-2014
Tabela 1.15.	Të huaj nga vendet e treta sipas vendit të konstatuar
Tabela 1.16.	Të huaj nga vendet e treta sipas shtetësisë
Tabela 1.17.	Të huaj refuzuar në hyrje sipas llojit të PKK
Tabela 1.18.	Të huaj refuzuar në hyrje sipas motivit
Tabela 2.1.	Popullsia e regjistruar për çdo qark, sipas gjinisë dhe grup-moshave, 2015
Tabela 2.2.	Shpërndarja e lejeve të punës së lëshuara për të huajt, sipas Zyrave të Punës
Tabela 2.3.	Lëshimi i lejeve të punës, kategorizuar sipas shteteve
Tabela 2.4.	Shpërndarja e profesionistëve të shëndetësisë
Tabela 2.5.	Shpërndarja e mjekëve dhe infermierëve sipas zonave urbano-rurale

## Lista e figurave

- Figura 1.1. Shtetas shqiptarë që kanë kërkuar azil në shtetet e BE
- Figura 1.2. Leje qëndrimi për shtetasit shqiptarë, 2013.
- Figura 1.3. Migrantët e brendshëm sipas grup moshës dhe gjinisë, 2014
- Figura 1.4. Norma bruto e migracionit të brendshëm neto, 2014
- Figura 1.5. Shtetas shqiptarë të deportuar nga vendet e BE, 2012-2014
- Figura 1.6. Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM, 2012-2014
- Figura 1.7. Shtetas shqiptarë të kthyer të paraqitur në SM sipas gjinisë, 2012- 2014
- Figura 1.8. Shtetas shqiptarë të kthyer të paraqitur në SM sipas tipit të kthimit për vitet 2012, 2013, 2014.
- Figura 1.9. Shtetas që kanë ndjekur kurset dhe janë certifikuar
- Figura 1.10. Dinamika e dërgesave në para të emigrantëve shqiptarë, 2003-2014
- Figura 1.11. Të huaj rezidentë në Shqipëri sipas kontinentit të origjinës dhe gjinisë
- Figura 1.12. Të huaj rezidentë në Shqipëri sipas grup-moshave
- Figura 1.13. Të huaj trajtuar me leje qëndrimi sipas motivit
- Figura 1.14. Të huaj trajtuar me leje qëndrimi sipas gjinisë
- Figura 1.15. Aplikime për leje qëndrimi, 2012, 2013, 2014
- Figura 1.16. Të huaj me mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri
- Figura 1.17. Lëvizja e imigrantëve nga vendet e treta në territorin e Shqipërisë.
- Figura 1.18. Të huaj nga vendet e treta në Qendrën e Mbyllur
- Figura 2.1. Ndarja e popullsisë së regjistruar sipas qarqeve, 2015
- Figura 2.2. Dinamika e popullsisë së regjistruar sipas qarqeve
- Figura 2.3. Treguesë demografikë në Shqipëri, 2012-2014
- Figura 2.4. Dinamikat e migracionit, 2012-2014
- Figura 2.5. Numri i emigrantëve sipas gjinisë dhe moshës, 2014
- Figura 2.6. Popullsia sipas tre grup-moshave kryesore dhe raportet e varësisë moshore, 2012-2014

## Lista e shkurtimeve

AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
BE	Bashkimi Evropian
BSH	Banka e Shqipërisë
DPKM	Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
DSHR	Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët
DPSH	Drejtoria e Policisë së Shtetit
INSTAT	Instituti i Statistikës
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MF	Ministria e Financave
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PZM	Profili i Zgjeruar i Migracionit
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
RSH	Republika e Shqipërisë
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SM	Sportelet e Migracionit
TIMS	Total Information Management System (Sistemi i Përgjithshëm i Menaxhimit të Informacionit)

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM



<b>Kryeqyteti:</b>	Tirana
<b>Sipërfaqja:</b>	E përgjithshme: 28,748 km <sup>2</sup> (tokë: 27,398 km <sup>2</sup> , ujë: 1,350 km <sup>2</sup> )
<b>Kufiri:</b>	Gjatësia e përgjithshme: 1079 km (tokësor: 717 km; detar: 362 km; Shtetet kufitare: Mali i Zi 151 km, Kosove 112 km, Maqedoni 172 km, Greqia 282 km)
<b>Popullsia:</b>	Popullsia e regjistruar sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile (shtetas shqiptarë): 4 329 326 Popullsia banuese sipas INSTAT (Popullsia mesatare vjetore 2014): 2 894 475; Dendësia: 100.7 banorë/km <sup>2</sup>
<b>Gjuha:</b>	Gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe. Në territoret e banuara nga minoritetet, përveç gjuhës shqipe, flitet dhe gjuha greke, serbo-kroate dhe maqedonase.
<b>Presidenti:</b>	Bujar Nishani
<b>Kryeministri:</b>	Edi Rama
<b>Qeverisja:</b>	Republikë Parlamentare

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Profili i Zgjeruar i Migracionit (PZM) i Republikës së Shqipërisë pasqyron zhvillimet migratore në vend gjatë periudhës 2012-2014. Rekomandimet e këtij botimi do të shërbejnë për përmirësimin e mirëqeverisjes së migracionit në vend si dhe për maksimizimin e lidhjes mes migrimit dhe zhvillimit të vendit.

Migracioni, si një problem i mprehtë global, europian, rajonal dhe kombëtar, përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me vendet fqinje, vendet anëtare të Bashkimit Evropian e me gjerë, si dhe një sfidë serioze në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Përgjithësisht Shqipëria vazhdon të konsiderohet si një vend origjine i emigrantëve ekonomikë, vend tranzit dhe destinacioni për imigrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët. Migrimi në kontekstin shqiptar vazhdon të karakterizohet më shumë nga emigrimi ndërkombëtar i popullsisë vendase dhe më pak nga imigrimi i të huajve në vend. Koeficienti i migracionit neto shënoi një rritje të lehtë si pasojë e rënies së numrit të emigrantëve, nga 52,3 mijë në vitin 2012, në 46,5 mijë në vitin 2014, si dhe nga rritja e kthimit të emigrantëve.

Shumica e emigrantëve shqiptarë ndodhen në Greqi, Itali, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Zvicër, Francë, ShBA dhe Kanada. Në vitin 2014 në Greqi kishte rreth 800 mijë, ndërsa në Itali rreth 503 mijë emigrantë shqiptarë. Sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, popullsia e Shqipërisë gjatë vitit 2011 ishte rreth 4.2 milion banorë. Ndërsa sipas Censusit të vitit 2011, popullsia rezidente në Shqipëri ishte 2,831,741 banorë. Diferenca midis shifrës së Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Censusit 2011, mund të vlerësohet në mënyrë të tërthortë si numri i emigrantëve shqiptarë në vitin 2011. Pra, Shqipëria kishte në vitin 2011 rreth 1.4-1.5 milion emigrantë të jashtëm ose rreth 33 përqind të popullsisë së vendit. Liberalizimi i regjimit të vizave me vendet e BE-së (Zona Shengen) në fundin e vitit 2010 ndikoi në reduktimin e emigracionit të parregullt shqiptar drejt vendeve të BE-së, sepse inkurajoi lëvizjen e lirë dhe të rregullt në vendet e zonës Shengen. Sidoqoftë, emigrimi i shtetasve shqiptarë ka vazhduar edhe pas vitit 2010. Vlen të theksohet se ndërkohë që fluksi i emigrimit të shtetasve shqiptarë ka dhënë shenja moderimi, fluksi i atyre shtetasve shqiptarëve që kërkojnë azil në vendet e BE-së u rrit gjatë vitit 2014.

Ndër faktorët kryesorë të emigrimit të shtetasve shqiptarëve dominojnë ato me natyrë ekonomike si, papunësia dhe varfëria. Gjatë vitit 2013 ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej 1.4 %, ndërsa në vitin 2014, rritja ekonomike ishte 1.9 %. Gjithashtu, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë në vitin 2013 arriti në 471 mijë lekë. Ndikimi i rritjes ekonomike në sistemin e mirëqenies dhe për rrjedhojë, edhe në prodhimin e flukseve migratore, lidhet me kontributin e degëve të ekonomisë në PBB dhe në punësim. Gjatë vitit 2013 kontributi kryesor në rritjen ekonomike erdhi nga shërbimet (44.7%), bujqësia (19%), ndërtimi (10.5%) dhe industria (12.5%). Ndërkohë, kontributi i sektorëve në punësim ishte shpërpjestimor, sidomos në rastin e bujqësisë dhe shërbimeve. Shërbimet thithin një pjesë të vogël të forcës së punës të formalizuar, ndërkohë që rezultojnë ndër sektorët me informalitet shumë të lartë. Papunësia, informaliteti në ekonomi dhe në tregun e punës ushqejnë flukset migratore. Në fund të vitit 2014 papunësia ishte rreth 17.3%, ndërsa papunësia rinore (grup-mosha 15-29 vjeç) ishte 32.5%. Rritja e nivelit të papunësisë nuk lidhet domosdoshmërisht me rritjen e numrit të të papunëve, por me përpjekjet e INSTAT-it për të zbuluar papunësinë e fshehtë, e cila para vitit 2014 nuk ishte llogaritur realisht. Llojet kryesore të

**emigrimit të rregullt** të shqiptarëve janë aktualisht tre: i) emigrimi me kontrata pune; ii) emigrimi në formën e bashkimit familjar të prindërve dhe fëmijëve të emigrantëve; iii) emigrimi për arsye studimi.

Përsa i përket kanaleve kryesore të **emigrimit të parregullt** ato janë: i) kufiri tokësor midis Shqipërisë dhe Greqisë dhe Shqipërisë e Malit të Zi, të cilat vazhdojnë të funksionojnë si kanale drejt Zonës Shengen përkatësisht nëpërmjet Greqisë, Kroacisë dhe Sllovenisë për qytetarët shqiptarë të cilëve u është ndaluar ligjërisht hyrja në Zonën Shengen; ii) zgjatja e qëndrimit në vendet evropiane pas skadimit të afateve ligjore të qëndrimit prej 90 ditësh; iii) aplikimi për azil në vendet e Bashkimit Evropian pa pasur arsye të qenësishme; iv) braktisja e fëmijëve, lënia e tyre në vendet e destinacionit dhe kthimi i prindërve në Shqipëri, dukuri e cila ka rritur numrin e emigrantëve të mitur të pashoqëruar; v) përdorimi i mundësisë për të hyrë lirisht në Zonën Shengen dhe për ta përdorur si trampolinë për të emigruar në mënyrë të parregullt në Mbretërinë e Bashkuar, ShBA dhe Kanada, me dokumenta të falsifikuara nëpërmjet linjave ajrore.

Komuniteti shqiptar jashtë vendit përbëhet aktualisht nga pesë grupe kryesore: i) emigrantët ekonomikë; ii) pjestarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë; iii) studentët; iv) azilkërkuesit dhe refugjatët; v) fëmijët e pashoqëruar. Grupet më të mëdha të Diasporës përbëhen nga emigrantët ekonomikë, pjestarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë dhe studentët, edhe pse nuk ka ende një përkufizim të saktë ligjor për Diasporën.

Shqipëria vazhdon të ketë një varësi të lartë nga dërgesat në para të emigrantëve. Prej vitit 2007, kur dërgesat në para të emigrantëve arritën nivelin më të lartë, 952 milionë Euro, dhe deri në vitin 2013 dërgesat erdhën në rënie, duke arritur në këtë vit pikën më të ulët 544 milionë Euro. Gjatë vitit 2014 ndodhi një rritje e lehtë në 592 milionë Euro, dukuri që tregon për fillimin e përmirësimit të pozitës së emigrantëve shqiptarë në tregjet e punës të vendeve pritëse.

Intensifikimi i kthimit të emigrantëve shqiptarë gjatë periudhës 2012- 2014 është i lidhur, përveçse me krizën në vendet pritëse, edhe me shtimin e herëpashershëm të flukseve të emigrantëve të parregullt nga Shqipëria. Tipologjitë e emigrantëve shqiptarë të kthyer gjatë vitit 2014 kanë qenë: i) kthim vullnetar i emigrantëve ekonomikë; ii) kthim i emigrantëve ekonomikë për shkak të krizës në vendet kryesore pritëse, Greqi dhe Itali; iii) kthimi i të miturve të ose jo të shoqëruar nga prindrit. Kontigjenti më i madh i emigrantëve ekonomikë të kthyer ka qenë nga Greqia dhe Italia. Vetëm një pjesë e shtetasve shqiptarë që kthehen nga emigracioni paraqiten pranë Sporteleve të Migracionit (SM). Këto të fundit, janë struktura të ngritura pranë zyrave publike të punësimit për t'u ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë të kthyer për lehtësimin e riintegrit të tyre në vend pas kthimit. Në të gjithë vendin janë ngritur 36 SM. Gjatë tre vitet e fundit janë paraqitur pranë SM-ve 3,541 shtetas shqiptarë të kthyer. Prej vitit 2012 ka një ulje të numrit të shtetasve shqiptarë që janë paraqitur në Sportelet e Migracionit.

Si vend destinacioni,, Shqipëria në vitet e fundit gjithashtu ka njohur formën e imigrimit tranzit, imigrimit të parregullt dhe atij të rregullt. Imigrimi tranzit ka shënuar rritje në vitet 2012, 2013 dhe 2014, duke u shfaqur në dy forma: i) hyrja e rregullt dhe përpjekja për të kaluar në mënyrë të parregullt përmes territorit të Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera të rajonit, me destinacion final vendet e BE-së (kryesisht shtetas nga Afganistani, Siria, Tunizia, Maroku, Algjeria, Palestina etj.); ii) në raste me të rralla, hyrja e

rregullt e më pas tranzitimi drejt vendeve të tjera (kryesisht shtetas turq dhe kosovarë). Imigrimi i parregullt në vitet 2012, 2013 dhe 2014 është zhvilluar kryesisht nëpërmjet hyrjes së rregullt dhe më pas qëndrimit të parregullt. Imigracioni i rregullt është zhvilluar kryesisht për motive punësimi, bashkimi familjar, studime, aktivitete humanitare dhe fetare. Në vitet 2012, 2013 dhe 2014 vihet re një rritje e numrit të imigrantëve të rregullt për motive studimi, si dhe një ulje e numrit të imigrantëve të përfshirë në aktivitete fetare dhe humanitare. Në vitin 2014 në Republikën e Shqipërisë qëndronin 9,091 shtetas të huaj, të cilët përfaqësonin 0.3 % të popullsisë së përgjithshme. Gjatë vitit 2014 u natyralizuan 140 shtetas të huaj. Për pasojë, numri total i shtetasve të huaj të natyralizuar në Shqipëri arriti në 845 persona. Imigrimi i forcës së huaj të punës nuk kërcënon vendet e punës së popullsisë shqiptare, për shkak se numri i punëtorëve të huaj është modest.

Numri i azilkërkuesve në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës 2012-2014 u rrit në mënyrë të ndjeshme: nga 16, në 409. Kryesisht kjo rritje ndodhi për shkak të ardhjes në vend të shtetasve iraniane të kampit Ashraf, në kuadër të marrëveshjes qeveritare. Gjatë vitit 2014 në Shqipëri u vendosën në këtë kuadër 281 shtetas iranianë. Ndërkohë, konfliktet e armatosura në vendet e Afrikës Veriore dhe atyre arabe, nga viti 2010 e në vazhdim, janë shoqëruar me valë të reja migratore, refugjatësh dhe azilkërkuesish nga këto vende drejt Shqipërisë kryesisht si vend tranzit, me destinacion final vendet e Bashkimit Evropian.

Migrimi i brendshëm dhe ndërkombëtar vazhdon të ndikojë në pakësimin dhe plakjen e popullsisë, krahas uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë. Në vitin 2014, në popullsinë e Shqipërisë, të rinjtë (0-14 vjeç) zinin 19,7% të popullsisë, popullsia në moshë pune (15-64 vjeç) zinte rreth dy të tretat (68,8%), ndërsa popullsia mbi 65 vjeç zinte rreth 12 % të popullsisë së vendit. Rënia demografike, regjistruar në vend gjatë dekadave të fundit, është vërejtur edhe gjatë periudhës 2012-2014, kur popullsia ka një rënie me rreth 6,000 banorë. Dy vitet e fundit, megjithatë, kanë regjistruar disa prirje stabilizimi. Shkalla e rritjes (uljes) së popullsisë nga -0,12 % në vitin 2012, arriti në -0,10 % në vitin 2014. Kjo ndodhi si rezultat i një rritjeje të lehtë të shtesës natyrore, si pasojë e rritjes së numrit të lindjeve.

Nga pikëpamja e ndikimit të migracionit, duhet theksuar se tregu i punës në Shqipëri është ende vulnerabël dhe ndikon në vazhdimin e flukseve migratore nga Shqipëria drejt vendeve me tregje pune më të zhvilluara. Disa tipare të këtij vulnerabiliteti janë: niveli i lartë i papunësisë rinore; niveli i lartë i papunësisë afatgjatë; tregu i punës mbetet refraktar dhe joelastik edhe ndaj të rinjve që shkollohen; shpërndarja e pabarabartë e papunësisë; papunësia e lartë në fshat e bujqësi; informaliteti në tregun e punës, etj. Disa prej tipareve të mësipërme kanë filluar të moderohen, por ndikimi i një pjese të tyre ka qenë prezent edhe gjatë vitit 2014 dhe ka inkurajuar flukset migratore. Popullsia në moshë pune rritet me ritme më të larta se forca e punës dhe numri i të punësuarve, çka përbën një sfidë për tregun e punës. Pra, ritmet e rritjes së punësimit nuk kanë mundur të ndjekin ritmet e rritjes së popullsisë. Shqipëria ka një shkallë shumë të lartë informaliteti në tregun e punës. Punësimi informal është i lidhur me të ardhurat e ulta dhe varfërinë dhe inkurajon flukset migratore. Qeveria po u jep përparësi zhvillimit të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, nxitjes së investimeve të huaja direkte dhe mbështetjes së ndërmarrjeve të huaja të përbashkëta. Këto përparësi ndihmojnë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe dekurajimin e fluksit migrator nga vendi.

Përmirësimet në sistemin shëndetësor gjatë dy viteve të fundit kanë ndikuar në dekurajimin e

flukseve migratore, duke rritur aksesin e popullsisë në shërbimet e përkujdesit shëndetësor dhe mjekësor, nëpërmjet masave për mbulimin shëndetësor universal; incentivat ndaj personelit mjekësor për mbulimin më të mirë shëndetësor të popullsisë në zonat e thella, malore dhe rurale; uljes së çmimeve dhe rritjes së cilësisë së barnave; harmonizimin e politikave shëndetësore me politikat e linjës, sidomos me politikat e punësimit, sociale, arsimore, ushqimore, bujqësore, të sportit etj.

Nga pikëpamja e zhvillimit të kuadrit ligjor dhe politik, në periudhën 2012-2014 janë hartuar një sërë aktesh ligjore që kanë synuar përmirësimin e përgjigjes ndaj sfidave migratore. Në vitin 2013 u miratua Ligji i ri për të Huajt dhe një sërë Vendimesh të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, nëpërmjet të cilave u përcaktuan fushat kyçe të menaxhimit të migracionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor të Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*). Republika e Shqipërisë ka gjithashtu një kuadër të mirë institucional në fushën e menaxhimit të migracionit. Sidoqoftë ndjehet nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit politik që do të mundësonte një mbrojtje më të mirë për emigrantët dhe imigrantët.

Ky raport përbëhet nga katër pjesë. Pjesa A analizon situatën dhe prirjet migratore në Shqipëri; Pjesa B pasqyron ndikimin e migrimit në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare; Pjesa C përshkruan kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit; dhe Pjesa D përmbledh përfundimet dhe rekomandimet kryesore për përmirësimin e politikave dhe mirëqeverisjen e migracionit në Shqipëri.



## **A. SITUATA DHE PRIRJET MIGRATORE**

### **A.1. Emigrimi i shtetasve shqiptarë**

#### **A.1.1. Stock-u migrator në raport me popullsinë**

Sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, rezulton se popullsia e Shqipërisë gjatë vitit 2011 ishte rreth 4.2 milion banorë. Ndërsa sipas Censurit të vitit 2011, popullsia rezidente në Shqipëri ishte 2,831,741 banorë.<sup>2</sup> Diferenca midis shifrës së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Censurit 2011, mund të vlerësohet në mënyrë të tërthortë si numri i emigrantëve shqiptarë gjatë vitit 2011. Pra, Shqipëria kishte në vitin 2011 rreth 1.4-1.5 milion emigrantë të jashtëm ose rreth 33 përqind të popullsisë së vendit. Ky numër është më i madh se gjysma e forcës së punës së vendit.<sup>3</sup>

#### **A.1.2. Flukset migratore bashkëkohore**

Pas vitit 1990 shqiptarët kanë realizuar tre cikle migruese, të cilat mund të konsiderohen intensive, të parregullta dhe evoluese<sup>4</sup>: i) dimri-pranvera 1990-1991, kur ndodhi emigrimi masiv drejt Italisë dhe Greqisë; ii) gushti i vitit 1991, kur ndodhi emigrimi masiv drejt Italisë; iii) pranvera e vitit 1997, kur ndodhi emigrimi masiv drejt vendeve të BE-së për shkak të pasigurisë së lartë në vend. Këto tri cikle u prodhuan nga veprimi i kombinuar i faktorëve shtytës ekonomikë dhe politikë. Në dy ciklet e para shqiptarët emigruan për t'i shpëtuar rregjimit totalitar që po rrëzohej. Në ciklin e tretë emigrantët ju larguan kaosit dhe pragut të luftës civile që rrezikonte vendin. Hapja e dyerve në vendet europiane për refugjatët kosovarë në vitin 1999, shkaktoi një ndryshim të "taktikave" të emigrantëve shqiptarë për të emigruar me identitet kosovar. Sidoqoftë, kjo formë migrimi u reduktua nga shumë vendet pritëse. Krahas këtyre cikleve, ka pasur një fluks të vazhdueshëm drejt vendeve fqinje (Greqi, Itali), si dhe vendeve të tjera më të largëta (ShBA-së dhe Kanada).

Pas vitit 2000 vërehet një rënie e flukseve migratore në mënyrë të parregullt nga Shqipëria për shkak të përmirësimit të klimës ekonomike në vend, procesit të bashkimit familjar, promovimit të kanaleve formale të migrimit (si përmes marrëveshjeve dypalëshe të punësimit me disa vende të BE-së, etj.) si dhe ashpërsimit të masave ndaj migracionit të parregullt nga autoritetet kufitare shqiptare dhe ato të vendeve të BE-së. Sidoqoftë, forma të migrimit të parregullt nga Shqipëria dejt vendeve të tjera kryesisht ato të vendeve të BE-së vazhdojnë, fakt ky i konfirmuar edhe nga numri i kthimeve të detyruara çdo vit. Gjatë vitit 2014 nga Shqipëria u larguan rreth 46 mijë persona.<sup>5</sup>

#### **A.1.3. Disa karakteristika aktuale të emigrimit të shtetasve shqiptarë**

Ashtu si edhe vendet e tjera ballkanike, Shqipëria ka ende një nivel të lartë të emigrimit familjar, të grave dhe fëmijëve, favorizuar nga afërsia kulturore, linguistike dhe gjeografike, nga kostoja e ulët e emigrimit në vendet fqinje si Italia dhe Greqia si edhe nga mundësitë ligjore për bashkim familjar në vendet kryesore pritëse të emigrimit.

Shqipëria ka prodhuar në mënyrë të vazhdueshme flukse të emigrimit të të miturve të pashoqëruar.

<sup>2</sup> INSTAT, Tiranë, 2012

<sup>3</sup> Barjaba, K. (2013) Kurthet e papunësisë, Tiranë: UET Press

<sup>4</sup> Barjaba, K & Barjaba, J. Embracing Emigration: The Migration-Development Nexus in Albania, in Migration Information Source, Online Journal of Migration Policy Institute, Washington DC, 10 September 2015

<sup>5</sup> INSTAT, Tiranë, 2015

Gjatë viteve të fundit këto flukse janë rritur. Në dhjetor 2014, Ministria italiane e Punës dhe Politikave Sociale <sup>6</sup> bënte të ditur se ishin 804 të mitur të pashoqëruar shqiptarë në territorin italian. Sipas ONM Tirana, vende të tjera të BE si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, etj., raportojnë gjithashtu një rritje të pranishmë të miturve të pashoqëruar nga Shqipëria, me qëndrim të paligjshëm ose që kërkojnë azil në këto vende. Statistikat e Eurostat për rastet e kërkesave për azil nga të miturit e pashoqëruar tregojnë një rritje të qenësishme që nga viti 2010 dhe për periudhën 2012-2014.

Niveli i lartë i emigrimit të njerëzve të kualifikuar është një tjetër karakteristikë e migrimit shqiptar.


Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, modelet e migracionit dhe qëndrimi i shqiptarëve ndaj tij kanë ndryshuar për shkak të politikave shtërnguese të vendeve pritëse dhe intensifikimit nga Shqipëria të luftës kundër migracionit të parregullt. Gjatë periudhës 2012-2014 që përkon dhe me ndikimin negativ të krizës ekonomike në disa vende të BE-së, kthimi i emigrantëve, sidomos nga Greqia dhe Italia, u rrit. Qeveria Shqiptare ka ofruar ndihmën e nevojshme për emigrantët e kthyer përmes ngritjes së një rrjeti kombëtar të Sporteleve të Migracionit.

Konfliktet e armatosura në vendet e Afrikës Veriore dhe arabe, nga viti 2010 e në vazhdim, janë shoqëruar me valë të reja imigratore nga këto vende drejt Shqipërisë si vend tranzit, me destinacion final vendet e BE-së. Sidoqoftë, Shqipëria vazhdon të ngelet vend jo shumë i preferuar për kërkim mbrojtjeje ndërkombëtare (si azil kërkues/refugjatë).

#### A.1.4. Fluksi i azilkërkuesve, shtetas shqiptarë në vendet e BE-së

Ndërkohë që fluksi i emigrimit të shqiptarëve në formë të parregullt është ulur ndjeshëm, fluksi i shtetasve shqiptarë që kërkojnë azil në vendet e BE-së është rritur gjatë viteve të fundit. Në figurën e mëposhtme paraqitet dinamika e kërkesave për azil në këto vende gjatë periudhës 2012-2014.

Figura 1.1. Shtetas shqiptarë që kanë kërkuar azil në shtete e BE-së, 2012, 2013, 2014



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015 (të dhëna të përpunuara)

Vendet kryesore ku shtetasit shqiptarë kanë kërkuar azil janë Gjermania, Greqia, Suedia, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Belgjika. Arsyet kryesore të azil -kërkimit kanë qënë ato ekonomike, duke çuar për rrjedhojë në nivele të larta refuzimi të kërkesës për azil nga vendet e BE-së.

<sup>6</sup> Rapporto Nazionale, Minori Stranieri non-Accompagnati, Ministero del Lavoro e delle Politiche Sociali, Roma, 31 Dicembre 2014

### A.1.5. Veçori të formimit dhe zhvillimit të Diasporës së Shqipërisë

Në mungesë të një përkufizimi zyrtar për Diasporën shqiptare, më së shumti, komunitetet shqiptare jashtë vendit përcaktohen bazuar në përkufizimin e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin e cila e përkufizon Diasporën si *“individët dhe pjestarët e rrjeteve, shoqatave dhe komuniteteve të cilët kanë lenë vendin e tyre të origjinës, por i ruajnë lidhjet me të”*.<sup>7</sup> Ky koncept përfshin komunitetet e punëtorëve emigrantë që janë vendosur përkohësisht në vende të tjera, emigrantët që kanë fituar nënshpëtimin e vendit pritës, emigrantët me dy shtetësi, dhe brezat e dytë dhe të tretë të emigrantëve.

Kufijtë kohorë të formimit të Diasporës së Shqipërisë ndryshojnë. E ashtëquajtuara “Diaspora e vjetër” përbëhet nga emigrantët që kanë emigruar para vitit 1990, ndërsa “Diaspora e re” nga emigrantët e emigruar pas këtyre viteve. Diaspora e vjetër është vendosur kryesisht në ShBA, Amerikën Latine, Australi, Turqi dhe disa vende të Evropës Perëndimore, ndërsa diaspora e re në Greqi, Itali, Angli, etj. dhe më pak në vendet e diasporës së vjetër.

### A.1.6. Përbërja e Diasporës shqiptare

Diaspora shqiptare përbëhet aktualisht nga pesë grupe kryesore: i) emigrantët ekonomikë; ii) pjestarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë; iii) studentët; iv) azilkërkuesit dhe refugjatët; v) fëmijët e pashoqëruar. Grupet më të mëdha të Diasporës përbëhen nga emigrantët ekonomikë, pjesëtarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë dhe studentët. Gjatë vitit 2014 pati një fluks në rritje të azilkërkuesve, sidomos drejt Gjermanisë.

### A.1.7. Harta e emigrimit të shtetasve shqiptarë

Harta e emigrimit të shtetasve shqiptarëve u formua nga valët spontane të emigrimit të viteve 1990-të. Shumica e emigrantëve u vendosën në Itali dhe Greqi. Në vitin 2008 në Greqi kishte 459,390 emigrantë shqiptarë të rregjistruar<sup>8</sup>, ndërsa në 1 janar 2014 në 1,246,500 imigrantë gjithsej. Duke u nisur nga fakti se shqiptarët përbëjnë rreth 65 % të emigrantëve, mund të dilet në përfundimin se në Greqi në këtë kohë ishin rreth 800 mijë emigrantë shqiptarë të rregjistruar.<sup>9</sup> Rritja e numrit të emigrantëve gjatë periudhës 2008-2014 ishte rezultat i flukseve të reja nga Shqipëria, por edhe nga vazhdimi i ritmeve të legalizimit të emigrantëve me qëndrim të parregullt në Greqi. Ndërsa në Itali në fund të vitit 2014 ishin rreth 503 mijë emigrantë shqiptarë.<sup>10</sup> Një pjesë e emigrantëve shqiptarë janë vendosur edhe në vende të tjera të BE-së, si Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Zvicër, Francë si edhe ShBA dhe Kanada. Të dhënat statistikore për emigrantët në këto vende janë të ndryshme, për shkak të pasaktësisë së burimeve të informacionit, sidoqoftë ky numër është të paktën 200 mijë.<sup>11</sup>

### A.1.8. Faktorët shtytës dhe tërheqës të emigrimit të shqiptarëve në periudhën 2012-2014

Emigrimi është produkt i faktorëve shtytës dhe tërheqës. Në rastin e emigrimit të shqiptarëve kanë

<sup>7</sup> IOM, 2011, fq.28, Fjalor i terminologjisë migratore.

<sup>8</sup> Mediterranean Migration Observatory & Migration and Migration Policy in Greece. Critical Review and Policy Recommendations. Anna Triandafyllidou. Hellenic Foundation for European and Foreign Policy (ELIAMEP)

<sup>9</sup> [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Foreign-born\\_population\\_by\\_country\\_of\\_birth\\_1\\_January\\_2014\\_\(%C2%B9\)\\_YB15.png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Foreign-born_population_by_country_of_birth_1_January_2014_(%C2%B9)_YB15.png)

<sup>10</sup> [http://www.stranieriinitalia.it/attualita-5.3.milioni\\_di\\_immigrati\\_regolari\\_in\\_italia\\_aumentano\\_nonostante\\_la\\_crisi\\_19305.html](http://www.stranieriinitalia.it/attualita-5.3.milioni_di_immigrati_regolari_in_italia_aumentano_nonostante_la_crisi_19305.html)

<sup>11</sup> Qendra e Studimeve për Migracionin, Tiranë, 2014

mbizotëruar faktorët shtytës në krahasim me ata tërheqës. Shqiptarët e konsiderojmë emigrimin si zgjidhje, jo si zgjedhje. Edhe faktorët shtytës janë të ndryshëm. Megjithatë, midis tyre mbizotërojnë faktorët ekonomikë. Papunësia mbetet një faktor shtytës që ushqen flukset migratore. Në fund të vitit 2014 papunësia ishte rreth 17.3%. Rritja e nivelit të papunësisë nuk lidhet domosdoshmërisht me rritjen e numrit të të papunëve, por me përpjekjet e INSTAT-it për të zbuluar papunësinë e fshehtë, e cila para vitit 2014 nuk ishte llogaritur realisht. Trysnia e faktorëve shtytës është ende e fortë në prodhimin e flukseve migratore.

Edhe pse faktorët shtytës mbizotërojnë, disa faktorë tërheqës vazhdojnë të jenë veprues. Midis tyre dallojnë faktorët arsimorë, ç'ka shprehet në numrin e madh të studentëve shqiptarë që studiojnë në universitetet e huaja: italiane, greke, amerikane, gjermane, hollandeze etj. Një tjetër faktor tërheqës vazhdon të jetë edhe aspirata e shqiptarëve të kualifikuar për të ndërtuar karrierën profesionale në vendet perëndimore. Ndër faktorët tërheqës mund të përmendet edhe mbështetja e emigrantëve të rinj ose potencialë prej emigrantëve ekzistuesë dhe familjeve të tyre në vendet pritëse.

#### **A.1.9. Kanalet e emigrimit të shtetasve shqiptarë në periudhën 2012-2014**

Emigrimi bashkëkohor i shtetasve shqiptarë nisi si një emigrim i parregullt. Ndërkohë, nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe për punësimin e qytetarëve shqiptarë në Greqi (1996) dhe Itali (1997), mundësitë ligjore për bashkim familjar si edhe mundësitë e studimit të të rinjve shqiptarë në universitetet europiane dhe amerikano-veriore, hapën rrugën e emigrimit të rregullt të qytetarëve shqiptarë drejt këtyre vendeve. Emigrimi i shqiptarëve mund të identifikohet gjatë dy serive kohore: 1990-2010 dhe pas vitit 2010, kur shqiptarëve iu krijua mundësia për lëvizje të lirë në Zonën Shengen.

Aktualisht kanalet kryesore të emigrimit të parregullt janë: i) kufiri tokësor midis Shqipërisë dhe Greqisë dhe Malit të Zi, i cili vazhdon të funksionojë si kanal drejt Zonës Shengen nëpërmjet Greqisë, Kroacisë dhe Sllovenisë për qytetarët shqiptarë të cilëve u është ndaluar ligjërisht hyrja në Zonën Shengen; ii) zgjatja e qëndrimit në vendet europiane pas skadimit të afateve ligjore të qëndrimit prej 90 ditësh; iii) aplikimi për azil në vendet e Bashkimit Evropian pa pasur arsye të qenësishme; iv) braktisja e fëmijëve, lënia e tyre në vendet pritëse dhe kthimi i prindërve në Shqipëri, dukuri e cila ka rritur numrin e emigrantëve fëmijë të pashoqëruar; v) përdorimi i mundësisë për të hyrë lirisht në Zonën Shengen dhe për ta përdorur më pas si trampolinë për të emigruar në mënyrë të parregullt në Mbretërinë e Bashkuar, ShBA dhe Kanada.


Format më të hasura të emigrimit të rregullt të shtetasve shqiptarë janë aktualisht tre: i) emigrimi me kontrata pune; ii) emigrimi në formën e bashkimit familjar të prindërve dhe fëmijëve të emigrantëve; iii) emigrimi për arsye studimi.

#### **A.1.10. Dinamika e legalizimit të emigrantëve shqiptarë në periudhën 2012-2014**

Gjatë viteve të fundit ritmet e legalizimit të emigrantëve shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian kanë qenë të moderuara për shkak se shumica e tyre janë legalizuar gjatë dekadës së fundit. Në vitin 2013, dy shtetet me numrin më të madh të lejeve të qëndrimit për shtetasit shqiptarë ishin Italia me 502,361 dhe Greqia me 340,841 leje qëndrimi. Ato ndiqeshin me një diferencë të madhe nga Belgjika me 4,533, Franca me 3,761, Spanja me 1,337, Austria me 1,372 dhe Zvicra me 1,242 leje

qëndrimi. Në Suedi ka ndodhur një rritje më e madhe e numrit të lejeve të qëndrimit për shtetasit shqiptarë gjatë tre viteve të fundit. Një rritje e lehtë është konstatuar edhe në Greqi dhe Itali. Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet numri i lejeve të qëndrimit për shtetasit shqiptarë në vendet kryesore pritëse europiane në vitin 2013.<sup>12</sup>

**Figura 1.2. Leje qëndrimi për shtetasit shqiptarë, 2013.**



Burimi: <http://www.pewglobal.org/2014/09/02/global-migrant-stocks/>


#### **A.1.11. Migrimi i brendshëm si “trampolinë” për migrimin e jashtëm**

Ndryshimet e popullsisë së qarqeve, rritja ose pakësimi i popullsisë së tyre, ndikohen jo vetëm nga dy komponentët kryesorë të ndryshimit të popullsisë (shtesa natyrore dhe migracioni neto), por edhe nga lëvizjet e brendshme të popullsisë. Gjatë vitit 2014, rreth 32 mijë banorë u zhvendosën brenda vendit, duke ndryshuar qarkun, qytetin ose fshatin e vendbanimit të zakonshëm. Migrantët e brendshëm janë përgjithësisht të rinj. Më shumë se 50% e migrantëve të brendshëm i përkasin grup-moshës 15-34 vjeç, ndërkohë grup-mosha 20-24 vjeç përbën rreth 20 % të migrantëve të brendshëm. Mosha mesatare e migrantëve të brendshme femra ishte 29 vjeç, ndërsa për meshkujt 33 vjeç. Gratë priren të migrojnë brenda vendit sesa burrat, duke përbërë 58% të migrantëve të brendshëm.<sup>13</sup> Tiparet demografike të migrantëve të brendshëm paraqiten në figurën e mëposhtme.

<sup>12</sup> Për vitin 2014 nuk ka të dhëna.

<sup>13</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Tiranë, 2014


**Figura 1.3. Migrantët e brendshëm sipas grup moshës dhe gjinisë, 2014**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Tiranë, 2015

Duke vlerësuar normat bruto të migracionit të brendshëm neto, pra raportin e diferencës midis hyrjeve dhe daljeve nga secili qark, me popullsinë përkatëse, shprehur për mijë banorë, konstatohet se qarqet Dibër, Berat dhe Kukës kanë një normë bruto të migracionit neto shumë të ulët. Ndërkohë vetëm dy qarqe, Tirana dhe Durrësi, kanë normat bruto të migracionit neto pozitive. Pra, në terma të përgjithshëm, 10 qarqe përjetojnë më tepër flukse dalje sesa hyrëse të popullsisë dhe, si rrjedhojë, kanë një normë të migracionit neto të brendshëm negative; në qarqet e Tiranës dhe Durrësit flukset hyrëse tejkalojnë dalëset, duke i bërë qarqet më të preferuara si destinacion për migrantët e brendshëm. Normat bruto të migracionit të brendshëm neto paraqiten në figurë.

**Figura 1.4. Norma bruto e migracionit të brendshëm neto, 2014**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Tiranë, 2015

Gjatë viteve 2012-2014 popullsia urbane ka ardhur në rritje. Pjesa më e madhe e individëve që kanë ndryshuar vendbanimin gjatë viteve të fundit kanë lëvizur drejt qendrave urbane, kryesisht Tiranë ose zonat përreth tij.

#### A.1.12. Intensifikimi i kthimit të emigrantëve shqiptarë në periudhën 2012-2014

Intensifikimi i kthimit të emigrantëve shqiptarë pas vitit 2009 është i lidhur, përveçse me krizën ekonomike në vendet pritëse, edhe me shtimin e herëpashershëm të flukseve të emigrantëve të parregullt nga Shqipëria. Gjatë viteve 2012-2014, sipas EUROSTAT, rezultoi një tendencë në rritje e shtetasve shqiptarë me qëndrim të parregullt në vendet e BE-së. Sipas INSTAT dhe ONM Tirana,<sup>14</sup> 133.544 migrantë shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç janë kthyer në Shqipëri në periudhën 2009-2013, prej të cilëve 98.414 meshkuj dhe 35.130 femra. Fluksi i kthimeve është rritur sidomos pas vitit 2009, ndërsa shumica e kthimeve kanë ndodhur në vitin 2012 dhe 2013 (53.4 përqind). Kthimet, ku dominojnë kthimet vullnetare (94 përqind) kanë ndodhur nga Greqia, 70.8 përqind, të ndjekura nga Italia 23.7 përqind dhe vende të tjera si Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, etj. Kthimet e emigrantëve shqiptarë janë kryesisht pasojë e krizës financiare botërore të vitit 2009 që goditi tregun e punës në vendet kryesore të destinacionit për migrantët shqiptarë.

Tipologjitë e emigrantëve shqiptarë të kthyer gjatë vitit 2014 kanë qenë tre: i) kthim vullnetar i emigrantëve ekonomikë; ii) kthim i emigrantëve ekonomikë për shkak të krizës në vendet kryesore pritëse, Greqi dhe Itali; iii) kthim i të miturve të shoqëruar/ose jo nga prindrit. Kontigjenti më i madh i emigrantëve të kthyer, në të katër format e mësipërme, ka qenë nga Greqia dhe Italia.

Përsa i përket kthimit të detyruar, sipas burimeve zyrtare,<sup>15</sup> gjatë vitit 2014 u kryen 1,928 operacione riatdhesimi të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE- së dhe vendet fqinje, nga të cilat 1,510 nga Greqia, 288 nga Maqedonia, 32 nga Mali i Zi, 73 nga Franca, 13 nga Mbretëria e Bashkuar, 5 nga Suedia, 2 nga Belgjika, 2 nga Luksemburgu, 1 nga Gjermania, 1 nga Spanja, 1 nga Zvicra. Gjatë vitit 2014 u riatdhesuan 21,658 shtetas shqiptarë ose 2,208 më shumë se në vitin 2013. Numri më i madh i të kthyerve, 71 % e totalit, ka qenë nga Greqia.

**Tabela 1.1. Numri i shtetasve shqiptarë të kapur në vendet e BE, 2012-2014**


Numri/Viti	2012	2013	2014
Numri i shtetasve shqiptarë të kapur në vendet e BE	18.610	27.035	30.430
Numri i shtetasve shqiptarë që ju është refuzuar hyrja në BE	13.195	12.980	14.275
Numri i shtetasve shqiptarë që ju është kërkuar të largohen nga BE	16.160	20.725	29.665

Burimi: EUROSTAT, 2015

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e shtetasve shqiptarë të deportuar nga vendet e BE-së në periudhën 2012-2014.

<sup>14</sup> Migracioni i kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013, INSTAT dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, 2014.  
<sup>15</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015.

**Figura 1.5. Shtetas shqiptarë të deportuar nga vendet e BE-së, 2012-2014**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga vendet e BE-së gjatë viteve të fundit, sipas grup-moshave.

**Tabela 1.2. Shtetas shqiptarë të kthyer sipas grupmoshës, 2012- 2014**

Viti	Totali	Meshkuj		Femra	
		Gjithsej	nën 18 vjeç	Gjithsej	Nën 18 vjeç
2012	14762	14097	495	665	46
2013	20751	20461	535	290	56
2014	20376	19354	397	1022	78

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Pra, rreth 96% e emigrantëve të kthyer në vitin 2012 kanë qenë meshkuj, kundrejt 4% femra, ndërkohë që në vitin 2014 meshkujt përbënin rreth 95% të të kthyerve. Kthimi i të miturve është kryer kryesisht pa procedura ripranimi dhe rezulton sa më poshtë

**Tabela 1.3. Shtetet kryesore kthyesë të të miturve të pashoqëruar, 2013-2014**

Viti	2013	2014
Greqia	803	611
Franca	34	92
Britania e Madhe	25	46
Zvicër	17	38
Suedia	14	29
Gjermania	10	28
Totali	972	907

Burimi: Sistemi TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, 2015



Numri i të miturve të pashoqëruar të kthyer nga vendet e BE-së, me procedurë ripranimi paraqitet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1.4. Kthimi i të miturve nga vendet e BE me procedurë ripranimi, 2014**

Shteti	2014	2014
Greqia	3 kërkesa	3 të ripranuar
Franca	4 kërkesa	3 të ripranuar
Suedia	6 kërkesa	2 të ripranuar
Italia	1 kërkesa	1 i ripranuar
<b>Totali</b>	<b>14 Kërkesa</b>	<b>9 të ripranuar</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015*

Gjatë vitit 2013 nuk ka patur asnjë kërkesë ripranimi për të mitur të pashoqëruar.

Gjatë vitit 2014 numri i të miturve të pashoqëruar që kërkuan azil në vendet të BE-së u rrit. Me qëllim parandalimin e këtij fenomeni, pritjen dhe trajtimin social pas rikthimit të tyre në familje, u miratuan akte të posaçme normative, si Urdhri i Brendshëm i Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 643, datë 17.12.2013 "Për marrjen e masave për ripranimin në Shqipëri të të miturve të pashoqëruar, verifikimin dhe fillimin e hetimeve në rastet kur prindërit apo kujdestarët ligjorë nuk përmbushin detyrimet ligjore"; dhe Urdhri i Përbashkët i Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Social Shtetëror, nr 332/3, datë 07/03.2014 "Mbi marrjen e masave për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen /ripranohen nga vendet e tjera".

#### **A.1.13. Shërbimet e Sporteleve të Migracionit ndaj emigrantëve të kthyer, 2012-2014**


Kthimi i emigrantëve, duke iu referuar studimit të INSTAT dhe IOM të vitit 2014, është intensifikuar gjatë viteve të fundit. Duke iu referuar moshës, rezulton se mosha më e zakonshme e kthimit varion ndërmjet 25 dhe 29 vjeç, ndërsa përqindja e të kthyerve në moshë pensioni është e e ulët, rreth 6 %. Duke iu referuar gjinisë, shumica e të kthyerve janë meshkuj, 73.7%, kundrejt 26.3%, femrave. Duke iu referuar gjendjes civile, rezulton se mbi 30% e të gjithë të kthyerve kanë mbajtur gjendjen e tyre civile "beqar/e" gjatë migracionit dhe pas kthimit në Shqipëri. Ndërkohë, përqindja e migrantëve që janë martuar jashtë vendit është më e lartë sesa e atyre që janë martuar pas kthimit në Shqipëri (11.8% kundrejt 6.6%). Duke iu referuar dëshirës së kthimit, rreth 94% e të kthyerve pranojnë se vendosën me vullnetin e tyre të kthehen, ndërsa më pak se 6% e tyre pranojnë se kanë qenë të detyruar të kthehen. Duke iu referuar vendit nga kthehen, Greqia ka qenë vendi i destinacionit të fundit për shumicën e të kthyerve (70.8%) e ndjekur nga Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania.<sup>16</sup>

Një pjesë e shtetasve shqiptarë që kthehen nga emigracioni paraqiten pranë Sporteleve të Migracionit (SM) që ndodhen në të gjitha zyrat rajonale dhe vendore të punësimit. SM-të janë struktura të ngritura për t'u ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë të kthyer për lehtësimin e riintegrit të tyre në vend pas kthimit përmes orientimit drejt shërbimeve publike në përputhje me

<sup>16</sup> Migracioni i kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013, INSTAT dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, 2014.

nevojat e tyre. Në të gjithë vendin janë ngritur 36 SM. Në zbatim të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015 dhe Planit të saj të Veprimit këto struktura intervistojnë shtetasit shqiptarë të kthyer që paraqiten në sportel, japin informacion për shërbimet publike dhe private, në përputhje me nevojat e identifikuara dhe referojnë te shërbimet publike dhe private si dhe projekte specifike të shoqërisë civile. Shtetasit e kthyer paraqiten vullnetarisht pranë sporteleve. Në tabelë paraqitet numri i shtetasve të kthyer, të regjistruar në SM gjatë tre viteve të fundit.

**Figura 1.6. Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM, 2012-2014**




Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Në tre vitet e fundit janë paraqitur pranë SM 3,541 shtetas shqiptarë të kthyer. Prej vitit 2012 ka një ulje të numrit të shtetasve shqiptarë që janë paraqitur në SM. Femrat përbëjnë gjysmën e të kthyerve të paraqitur pranë tyre. Numri i lartë i femrave lidhet me faktin se shumica e emigrantëve që janë paraqitur në sportele shprehen se janë kthyer familjarisht për afat të gjatë.

Në tabelën e mëposhtëme paraqitet numri i shtetasve shqiptarë të kthyer, të regjistruar në SM gjatë tre viteve të fundit, sipas gjinisë.


**Figura 1.7. Shtetas shqiptarë të kthyer të paraqitur në SM sipas gjinisë, 2012- 2014**



Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Numri më i madh i kthimeve është afatgjatë dhe familjar. Ky grup shfaq nevojë më të mëdha për mbështetje e shërbime për riintegrim. Tipologjitë e shtetasve të kthyer që janë paraqitur në SM kanë mbetur të njëjta në tre vitet e fundit. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i shtetasve shqiptarë të kthyer, të regjistruar në SM gjatë tre viteve të fundit, sipas tipit të kthimit.

**Figura 1.8. Shtetas shqiptarë të kthyer të paraqitur në SM sipas tipit të kthimit 2012- 2014**



Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Dy vendet kryesore nga janë kthyer shtetasit shqiptarë janë Greqia dhe Italia. Pjesa më e madhe, rreth 80 %, e shtetasve shqiptarë të kthyer të paraqitur pranë SM vinin nga Greqia, ndërsa 14% nga Italia. Të kthyerit nga vende të tjera të BE dhe jo-anëtare të BE të paraqitur në SM përbënin rreth 6% të të paraqiturve në SM. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i shtetasve shqiptarë të kthyer, të regjistruar në SM gjatë tre viteve të fundit, sipas shtetit nga janë kthyer.

**Tabela 1.5. Shtetasit shqiptarë të paraqitur në SM sipas shtetit nga janë kthyer, 2012-2014.**

Shteti/Viti:	2012		2013		2014	
Greqi	1321	86	963	82 %	679	81
Itali	188	12.2	131	11 %	121	14
Vende të tjera të BE	17	1.1	64	5.4 %	21	2.5
Vende jo anëtare të BE	10	1	13	1 %	12	2

Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Shumica e kthimeve ka ndodhur për shkak të papunësisë në vendin pritës. Një pjesë e kthimeve ka ardhur për shkak të mungesës së dokumentacionit në vendin pritës, por ato nuk zënë një vend të madh krahasuar me numrin e kthimeve për shkak të papunësisë. Gjatë viteve 2012-2014, numri i të kthyerve për motive të tjera, ndër të cilat investimet, ka ardhur duke u rritur. Megjithatë ai është ende i vogël. Një arsye për këtë mund të jetë mosparaqitja e këtij grupi në sportele për shkak se vijnë me një plan të mirëmbledhur dhe punojnë për ta vënë në zbatim. Pjesa që paraqitet në SM ende nuk e ka të konsoliduar ose i mungojnë fondet për të investuar e hapur biznes dhe kanë nevojë për më shumë informacion. Në përgjithësi, shkaqet që i kanë shtyrë shtetasit shqiptarë të kthehen përgjatë viteve 2012– 2014 nuk kanë pasur ndryshime të mëdha. Megjithatë, në vitin 2014 vihet re një ulje e kthimeve për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe një rritje e kthimeve për shkaqe të tjera (jo papunësisë). Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i shtetasve shqiptarë të kthyer, të regjistruar në SM gjatë tre viteve të fundit, sipas shkakut të kthimit.

**Tabela 1.6. Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM sipas shkakut të kthimit, 2012-2014**

Shkakut i kthimit/Viti:	2012		2013		2014	
Papunësia	1348	88 %	1060	91 %	736	88 %
Mungesa e dokumentacionit	31	2 %	67	5.1 %	43	5 %
Për të investuar	9	1 %				
Shkaqe të tjera			43	3.7 %	55	6.5 %

Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Pjesa më e madhe e shtetasve shqiptarë të kthyer të paraqitur në SM u përkasin grup-moshave 25-34 vjeç, 35-44 vjeç dhe mbi 45 vjeç. Kjo lidhet me faktin se në këto grup-mosha individët kanë krijuar familje dhe janë në kërkim të punës dhe plotësimit të nevojave të tjera. Numri i shtetasve në moshë 15-24 vjeç ka qenë i vogël krahasuar me grup-moshat e tjera dhe ka pësuar një rënie të lehtë në vitet 2012-2014. Nuk ka ndryshim të madh në vite për sa i përket grup-moshave të shtetasve shqiptarë të kthyer, të cilët janë paraqitur në sportele. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i

shtetasve shqiptarë të kthyer, të regjistruar në SM gjatë tre viteve të fundit, sipas grup-moshave.

**Tabela 1.7. Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM sipas grup-moshave, 2012- 2014.**

Grupmosha/Viti	2012		2013		2014	
15 deri 24 vjeç	167	11 %	113	9.7 %	67	8 %
25 deri 34 vjeç	442	29 %	333	28 %	265	32 %
35 deri 44 vjeç	455	30 %	345	29 %	257	30 %
45 e në vazhdim	472	31 %	380	32 %	245	29 %

Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Pjesa më e madhe e shtetasve shqiptarë të kthyer të paraqitur pranë SM kanë paraqitur si nevojë gjetjen e një pune, për të cilën kanë marrë këshillim.. Ky grup ndiqet nga grupi i shtetasve të kthyer, të cilët kanë kërkuar e marrë informacion për formim profesional, i cili është rritur në vitet 2013-2014. Një pjesë e të kthyerve kanë marrë informacion për shërbimet mjekësore. Është më i vogël numri i të kthyerve që kanë kërkuar informacion për ndihmën ekonomike dhe mbështetjen në të ardhura. Të kthyerit që kanë kërkuar informacion për hapjen e një biznesi zënë një përqindje të vogël, që vjen duke u rritur. Një grup të kthyerish kanë marrë informacion për shërbime të tjera. Gjatë viteve 2012- 2014 kanë marrë pranë SM këshillim për punësim 2,400 shtetas të kthyer, orientim profesional 677 persona, informim për shërbimet shëndetësore 973 persona, informacion për mbështetje me të ardhura 553 persona, informacion për hapje biznesi 104 persona dhe informacion për shërbime të tjera 130 persona. Në tabelë paraqitet numri i të kthyerve, të regjistruar gjatë tre viteve të fundit, sipas shërbimeve të përfituara.


**Tabela 1.8. Shtetasit shqiptarë të kthyer sipas shërbimeve të përfituara në SM, 2012- 2014**

Shërbime të përfituara	2012		2013		2014	
Këshillim për punësim	1005	65.4 %	814	70 %	581	70 %
Orientim profesional	246	16%	226	19%	205	24.5 %
Informim për shërbimet mjekësore	496	32.29 %	258	22 %	219	26 %
Mbështetje me të ardhura	227	15 %	226	19 %	100	12 %
Hapje biznesi	44	3 %	18	1.6%	42	5 %
Shërbime të tjera			68	6%	62	7 %

Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Shtetasit shqiptarë të kthyer të paraqitur pranë SM, që kanë kërkuar formim profesional janë referuar drejt kurseve të formimit profesional. Këto kurse në Qendrat Publike të Formimit Profesional janë falas. Në periudhën 2012-2014 kanë marrë pjesë në kurset e formimit profesional pranë qendrave publike të formimit profesional, 591 shtetas shqiptarë të kthyer. Kurset profesionale me frekuencim më të madh nga të kthyerit kanë qenë ato për instalues dhe riparues rrjeti, kuzhinier, rrobaqepësi, menaxhim ndërmarrjesh, hidraulik, parukeri, instalues panelesh diellore. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i shtetasve shqiptarë të kthyer, të regjistruar në SM gjatë tre viteve të fundit, të cilat janë kualifikuar profesionalisht.

**Figura 1.9. Shtetas që kanë ndjekur kurset dhe janë çertifikuar, 2012-2014**



Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.  
MMSR, SHKP, Tiranë, 2015

Të kthyerve në moshë shkollore trajtohen u krijohen lehtësi për përfshihen në sistemin arsimor. Referuar të dhënave të MAS, në vitin shkollor 2013-2014 janë regjistruar në arsimin parauniversitar mbi 2,060 fëmijë të kthyer nga emigracioni. Që prej vitit 2010, shpërndan në pikat kufitare si dhe pranë DAR/ZA materiale informuese mbi arsimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga emigracioni.

**Tabela 1.9. Riintegrimi arsimor i emigrantëve të kthyer, 2014**

Nr. i fëmijëve të shtetasve shqiptarë të kthyer që kanë lindur j/shtetit dhe janë regj. për herë të parë në sistemin arsimor shqiptar.	1628
Nr. i shtetasve të kthyer, që janë regjistruar në sistemin arsimor shqiptar, për të vazhduar studimet e nisura jashtë vendit.	2062
Numri i fëmijëve të shtetasve shqiptarë të ripranuar, që janë sistemuar në arsimin parauniversitar shqiptar.	36
Numri i njehsimeve të dëftesave dhe të dokumentacionit shkollor	1876

Burimi: MAS, 2015

#### A.1.14. Rritja e lehtë e dërgesave në para të emigrantëve

Shqipëria vazhdon të ketë një varësi të lartë nga dërgesat në para të emigrantëve. Prej vitit 2007, kur dërgesat arritën nivelin më të lartë, 952 milionë Euro, dhe deri në vitin 2013 dërgesat erdhën në rënie, duke arritur në këtë vit pikën më të ulët 544 milionë Euro. Gjatë vitit 2014 ndodhi një rritje e lehtë në 592 milionë Euro.<sup>17</sup>

<sup>17</sup> Banka e Shqipërisë, 2015

**Figura 1.10. Dinamika e dërgesave në para të emigrantëve shqiptarë, 2003-2014**



Burimi: <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/1074/Remitancat-si-flukse-hyrese-dhe-dalese-2014>

Rënia e dërgesave ka ndodhur për shkak të krizës në vendet pritëse, Greqi dhe Itali, por edhe për shkaqe të tjera: maturimi i procesit migrator, mplakja e brezit të parë të emigrantëve, rritja e shpenzimeve për brezin e dytë dhe të tretë të emigrantëve, kristalizmi i projekteve migratore, rritja e kostos së shërbimeve publike dhe jetesës në vendet pritëse, modifikimi i sjelljes dhe projekteve individuale e familjare, për shkak të pasigurisë që shkakton kriza financiare etj.

## **A.2. Imigrimi drejt Shqipërisë**


### **A.2.1. Shqipëria si vend pritës**

Në Shqipëri jetojnë katër grupe rezidentësh të huaj: i) imigrantë të rregullt ekonomikë dhe ii) për motive të tjera; iii) studentë, azilkërkues; iv) të huaj të natyralizuar. Gjatë vitit 2014 Shqipëria ka shërbyer si vend pritës për imigrantë ekonomikë, refugjatë dhe azilkërkues.

#### **A.2.1.1. Imigrantët e rregullt rezidentë në Shqipëri, 2012-2014**

Numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj që qëndrojnë në Shqipëri ka mbetur përafërsisht në nivelin 0.3 % të popullsisë vendase gjatë dekadës së fundit. Numri dhe origjina e imigrantëve të rregullt nuk ka shënuar ndryshime të theksuara. Në vitin 2012, rreth 74% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë europiane, 10% nga Azia, 13 % nga Amerika dhe 2% nga Afrika. Në vitin 2013, 74% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë europiane, 12% aziatike, 11 % amerikane dhe 3% afrikane. Në vitin 2014, imigrimi nga vendet europiane zinte 75%, ndërkohë që 13 % vinin nga kontinenti amerikan, 10 % nga kontinenti aziatik dhe numri i emigrantëve nga shtete të tjera ishte i papërfillshëm, rreth 1-2 %. Në figurë paraqiten të dhënat mbi të huajt rezidentë në Shqipëri sipas origjinës dhe gjinisë.


Figura 1.11. Të huaj rezidentë në Shqipëri sipas origjinës dhe gjinisë, 2012, 2013, 2014



Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Tiranë, 2015.

Në figurë paraqiten të dhënat mbi të huajt rezidentë në Shqipëri sipas grup-moshave.

Figura 1.12. Të huaj rezidentë në Shqipëri sipas grup-moshave, 2012, 2013, 2014



Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Tiranë, 2015.

Nga të dhënat sipas grup-moshave, rezultojnë një rritje e të huajve rezidentë të moshës 30-39 vjeç.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mbi të huajt rezidentë në Shqipëri sipas shtetësisë.



**Tabela 1.10. Të huaj rezidentë në Shqipëri sipas shtetësisë, 2012, 2013, 2014**


Shteti	2012	2013	2014
Turqi	991	1112	1392
Itali	893	1082	1585
Kosovë	437	576	803
Greqi	304	360	286
SHBA	461	315	262
Kanada	206	191	253
Kinë	169	142	200
Kroaci	102	135	122
Maqedoni	122	126	137
Gjermani	120	118	143
Mbretëri e Bashkuar	111	103	142
Rumani	96	94	97

*Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit,, Tiranë, 2015.*

Përsa i përket shtetësive, dominojnë ajo turke dhe italiane. Ndërmjet imigrantëve europianë për vitin 2014, rreth 23% ishin Italianë, 20% ishin turq, 15% ishin nga Kosova dhe nga Maqedonia dhe 30% nga vende të tjera. Rreth 30% e imigrantëve aziatikë erdhën nga Kina. Imigrantët nga SHBA përbënin 61% të emigrantëve të kontinentit amerikan, ndërsa kanadezët 26%. Imigrantët nga shtetet afrikane zinin 3 % të aplikimeve për vitin 2014. Prurjet migratore nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia për vitin 2014 janë dominuar nga ata me kombësi shqiptare.


Sipas motiveve të qëndrimit, numrin me të madh të të huajve e përbëjnë ata që qëndrojnë në Shqipëri për motive punësimi, me afat mbi 12 muaj, kryesisht meshkuj, përqëndruar kryesisht në qytetin e Tiranës. Të dhënat për të huajt që aplikuan për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë gjatë viteve 2012- 2014 janë paraqitur në figurat e mëposhtme.

**Figura 1.13. Të huaj që ju është lëshuar leje qëndrimi sipas motivit, 2012, 2013, 2014**



*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015*


**Figura 1.14. Të huaj që ju është lëshuar leje qëndrimi sipas gjinisë, 2012- 2014**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Sipas të dhënave të Regjistrit Elektronik për të Huajt (FER), gjatë vitit 2014 u pranuan dhe vlerësuan 6,847 aplikime të shtetasve të huaj për leje qëndrimi. Në figurën e mëposhtme paraqitet dinamika e kërkesave për leje qëndrimi në Shqipëri gjatë viteve 2012-2014, sipas rajoneve.

**Figura 1.15. Aplikime për leje qëndrimi, 2012- 2014**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Siç shihet nga figura 1.15, gjatë vitit 2014 u paraqitën dhe u pranuan dhe vlerësuan më shumë kërkesa për leje qëndrimi, krahasuar me vitet 2012 dhe 2013. Ashtu si edhe shumica e rezidentëve, edhe shumica e aplikantëve të rinj për leje qëndrimi janë përqëndruar në Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Durrës.

### A.21.2. Studentët e huaj në universitetet shqiptare, 2012- 2014

Gjatë viteve të fundit numri i studentëve të huaj në universitetet shqiptare ka ardhur në rritje: nga 471 në 2012, në 709 në 2013 dhe 690 në 2014. Rënia e numrit të studentëve të huaj në vitin 2014 shpjegohet me reformën e arsimit të lartë dhe mbylljen e disa universiteteve private në Shqipëri. Shumica e studentëve të huaj vijnë nga popullsia shqiptare në vendet e rajonit, Kosovë dhe Maqedoni, si edhe nga Turqia dhe Italia.

Tabela 1.11. Të huaj që studiojnë në Shqipëri, 4 shtetësitë kryesore

	2012	2013	2014
Turqi	214	282	86
Itali	185	342	493
Kosovë	52	63	88
Maqedoni	20	22	23


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

### A.2.1.3. Trajtimi i azilkërkuesve, 2011-2014

Gjatë vitit 2014 ndodhi një rritje e vullshme e azilkërkuesve në Shqipëri. Numri i tyre u rrit rreth 2.6 herë, nga 158 në 409. Kryesisht kjo rritje ndodhi për shkak të mbërritjes në Shqipëri të shtetasve iranianë të kampit Ashraf, në kuadër të një marrëveshjeje qeveritare. Gjatë vitit 2014 në Shqipëri u vendosën në këtë kuadër 281 shtetas iranianë.

Dinamika e të huajve me mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri paraqitet në figurën e mëposhtme:

Figura 1.16. Të huaj me mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri, 2011-2014



Burimi: Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, Tiranë, 2015

Dinamika e të huajve me mbrojtje ndërkombëtare, sipas shtetësisë, paraqitet në figurë:

**Tabela 1.12. Të huaj azilkërkues sipas shtetësisë, 2012, 2013, 2014**

Shtetësia/Viti	2012	2013	2014
Kosovë	1	-	8
Irak	1	-	1
Ukrainë	-	-	1
Eritrea	-	-	11
Iran	-	137	276
Sudan	-	-	2
Gambia	-	-	3
Afrika Jugut	-	-	1
Liban	-	-	1
Dagestan	-	-	1
Azerbaxhan	-	-	5
Afganistan	2	-	2
Siri	-	18	97
Pakistan	1	-	-
Jordani	5	-	-
Bosnjë-Hercegovinë	-	1	-
Kroaci	-	1	-
Mali i zi	-	1	-
<b>TOTAL</b>	<b>10</b>	<b>158</b>	<b>409</b>

*Burimi: Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatet, Tiranë, 2015*

Gjatë vitit 2012 iu njoh statusi i refugjatit 2 azilkërkuesve nga Kosova, 1 nga Siria, 1 nga Turqia. Gjatë vitit 2013 iu njoh statusi i refugjatit 2 azilkërkuesve nga Kosova, 1 nga Siria, 1 nga Afganistani. Gjatë vitit 2014 iu njoh statusi i refugjatit 2 azilkërkuesve nga Kosova. Gjatë vitit 2014: iu njoh statusi i mbrojtjes plotësuese 2 azilkërkuesve nga Kosova dhe 2 azilkërkuesve nga Siria; iu njoh statusi i mbrojtjes së përkohshme 2 azilkërkuesve nga Kosova; u morrën vendime pushimi për 32 shtetas sirianë, 1 irakian, 1 iranian dhe 1 afrikano-jugor; u morrën vendime për refuzimin e statusit të refugjatit për 1 shtetas iranian dhe 1 ukrainas.<sup>18</sup>

Në tabelë paraqiten të dhëna mbi vendimet e pezullimit të kërkesave sipas shtetësisë.

**Tabela 1.13. Vendime pezullimi sipas shtetësisë, 2014**

Shtetësia	2014
Irak	1
Ukrainë	1
Eritrea	11
Sudan	2
Gambia	3
Liban	1
Azerbaxhan	2
Afganistan	2

<sup>18</sup>Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatet, 2015

Siri	51
TOTAL	75

Burimi: Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, Tiranë, 2015

#### A.2.1.4. Natyralizimi i shtetasve të huaj në Shqipëri

Vetëm një pjesë e vogël e të huajve rezidentë kërkojnë shtetësinë shqiptare. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat mbi aplikimet për shtetësi shqiptare gjatë tre viteve të fundit. Shumica e kërkesave për shtetësi bëhen nga shtetas kosovarë dhe turq.

**Tabela 1.14. Aplikime për marrjen e shtetësisë shqiptare, 2012, 2013, 2014**

	2012	2013	2014
Fitim shtetësie	205	221	553
Dhënie shtetësie	-	59	140
Njohje shtetësie	-	-	76
Rifitim shtetësie	124	64	76


Burimi: Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, Tiranë, 2015

#### A.2.2. Shqipëria si vend tranzit

Pozita gjeografike e Ballkanit, vendosur në kryqëzim të rrugëve të cilat kanë si drejtim përfundimtar Evropën Qëndrore e kthejnë këtë zonë dhe shtetet përbërëse të saj në një hapësirë, e cila mund të shfrytëzohet si zonë tranzit për shtetasit e vendeve të treta, të cilët lëvizin në mënyrë të parregullt.

Gjatë vitit 2014 nëpërmjet territorit të Shqipërisë kanë tentuar të kalojnë tranzit shtetas nga Lindja e Mesme dhe vendet arabe. Imigrantët nga vendet e treta kryesisht hyjnë në Turqi, më pas kalojnë në Greqi dhe nëpërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor synojnë vendet e BE-së dhe kryesisht ato veriore. Drejtimi i mëtejshëm i lëvizjes së tyre ka qene Shqipëri-Mali i Zi- Kroaci dhe me pas vendet e BE-së. Rrugët kryesore të cilat përdorin shtetasit e vendeve të treta ilustrohen në figurën e mëposhtme.

Figura 1.17. Lëvizja e imigrantëve nga vendet e treta në territorin e Shqipërisë.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Gjatë vitit 2014, pati një rritje të ndjeshme të numrit të shtetasve huaj, të kapur në tentativë për të kaluar në mënyrë të paligjshme tranzit nëpër Shqipëri. Numri i shtetasve të kapur gjatë këtij viti (2,618) ishte 32.3 % më i lartë se numri i shtetasve të huaj të kapur një vit më parë (1978). Në vitin 2013 rreth 53 % e tyre u kapën në brendësi të territorit, ndërsa 47 % në afërsi të kufirit shtetëror dhe në PKK. Ndërsa gjatë vitit 2014 vërehet një përmbyasje e shifrave: rreth 33.8% e shtetasve u kapën në brendësi të territorit, ndërsa 66.2% në afërsi të kufirit shtetëror dhe në Pikat e Kalimit Kufitar (PKK).

Numri i shtetasve të huaj që u kapën duke hyrë në mënyrë të paligjshme nga Greqia u rrit në krahësim me vitin 2013, nga 816 në 1,635. Kanë preferuar të përdorin territorin e Shqipërisë kryesisht ata shtetas që janë gjendur në pjesën e Janinës dhe Igumenicës në Greqi për shkak të distancës së shkurtër për të përshkruar territorin shqiptar. Me qëllim vështirësimit të procedurave të kthimit në Greqi, këta shtetas kanë preferuar të udhëtojnë pa dokumente udhëtimi si dhe duke fshehur provat për vendin nga kishin hyrë në Shqipëri.

Numri i i shtetasve të huaj që tentuan të kalonin nga Shqipëria në drejtim të Malit të Zi në mënyrë të paligjshme u ul nga 127 në 72. Vërehet se të ndaluarit nuk kanë preferuar të kërkojnë azil apo të qëndrojnë në Shqipëri në momentin e ndaljes nga shërbimet e kufirit dhe migracionit, por kanë deklaruar se duan të vazhdojnë rrugën drejt vendeve të BE-së.

Tabela 1.15. Të huaj nga vendet e treta sipas vendit të konstatuar, 2012, 2013, 2014

Të huaj të parregullt	2012	2013	2014
Në zonë kufitare	1068	959	1712
Në PKK	26	11	17
Në territor	79	996	778
Totali	1182	1978	2618

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Për sa i përket origjinës së shtetasve të huaj të kapur në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit, numri më i lartë vjen përsëri nga Siria (1,941), Eritrea (324), Kongo (64) shtetas, ndërkohë që në vitin 2014 vërehet një ulje e ndjeshme e shtetasve të kapur nga Pakistani, Somalia dhe Afganistani.


**Tabela 1.16. Të huaj nga vendet e treta sipas shtetësisë, 2012, 2013, 2014**

Shtetësia/Viti	2012	2013	2014
Algjeri	439	66	-
Siri	163	543	1941
Marok	147	47	-
Afganistan	127	138	35
Palestine	99	-	17
Tunizi	79	13	-
Pakistan	26	400	30
Kongo	-	-	64
Guinea	-	11	19
Somalia	-	204	48
Sudan	-	82	44
Eritrea	-	274	324
Nigeri	-	38	-
Indi	-	13	-
Komora	-	12	-
Të tjera	102	132	96

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Për shtetasit e huaj nga vendet e treta në territor është aplikuar procedura e largimit mbi baza vullnetare dhe pjesërisht janë trajtuar në Qendrën Pritëse të Mbyllur, duke vijuar me procedurat e kthimit mbi baza të marrëveshjeve dypalëshe mes Shqipërisë dhe vendeve të origjinës/të tranzitit. Numri i personave të trajtuar në Qendrën e Mbyllur u rrit rreth 29%: nga 331 në 2013, në 472 në 2014.

**Figura 1.18. Të huaj nga vendet e treta në Qendrën Pritëse të Mbyllur, 2012- 2014**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Gjatë vitit 2014 largimet vullnetare kanë qenë më të shumta sesa largimet me forcë nëpërmjet ndalimit në Qendrën e Mbyllur e më pas dëbimit nga territori.

Nunri i shtetasve të cilëve u është refuzuar hyrja sipas PKK-ve (tokësore, ajrore, detare) dhe sipas viteve 2013/2014, pasqyrohet në tabelë.

**Tabela 1.17. Të huaj refuzuar në hyrje sipas llojit të PKK, 2012- 2014**

Kufiri/Viti	2012	2013	2014
Tokësor	278	209	366
Ajror	100	90	101
Detar	12	6	5
Shuma	390	305	472

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015

Përgjithësisht, refuzimet kanë ndodhur për arsye të mungesës së dokumenteve të udhëtimit dhe të automjeteve, dokumente të pavlefshme, mungesës së vizës, tejkalimit të afatit të qëndrimit, mungesës së mjeteve financiare, si dhe mos justifikimit të të qëllimit të udhëtimit.

**Tabela 1.18. Të huaj të refuzuar në hyrje sipas motivit, 2012- 2014**

Arsyeja e refuzimit/Viti	2012	2013	2014
Dokumentacion i pavlefshëm, mungesë vize	225	152	169
Nuk justifikon qëllimin	64	54	98
Tejkalim afati qëndrimi	7	16	43
Njoftim në sistem	9	6	25
Mungesë mjeteve financiare	11	10	6
Nuk plotëson kushtet e qëndrimit në RSH			9
Të tjera	74	67	124

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2015




## B. NDIKIMI I MIGRIMIT NË EKONOMINË DHE SHOQËRINË SHQIPTARE

### B.1. Migrimi dhe zhvillimi demografik

#### B.1.1. Popullsia e Shqipërisë

Sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, struktura e popullsisë në fund të vitit 2014 ishte:


Figura 2.1. Ndarja popullsisë së regjistruar sipas qarqeve 2012- 2014



Burimi: Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC), Tiranë, 2015

Dinamika e popullsisë sipas qarqeve ishte si më poshtë:

Figura 2.2. Dinamika e popullsisë së regjistruar sipas qarqeve, 2012- 2014



Burimi: Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Tiranë, 2015

Pas ngritjes së sistemit të RKGJC në fillim të 2009, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore dhe procedurat përkatëse, nga shërbimi i gjendjes civile ka vijuar puna për saktësimin dhe konsolidimin e të dhënave të këtij sistemi. Për periudhën 2011-2014 vihet re një rritje e vogël e popullsisë në zonat urbane dhe një ulje e vogël e popullsisë në zonat rurale. Ky ndryshim shpjegohet me procesin e konsolidimit të të dhënave të RKGJC si edhe me lëvizjen demografike të popullsisë gjatë këtyre viteve.

Gjate periudhës 2011-2015 ndodhi një rritje 2.71% e popullsisë së vendit. Popullsia e regjistruar sipas grup-moshave dhe gjinisë rezulton si më poshtë:

**Tabela 2.1. Popullsia e regjistruar për çdo qark, sipas gjinisë dhe grup-moshave, 2014:**

Qarku	Përqindja sipas gjinisë		Përqindja sipas grup-moshave		
	Femra	Meshkuj	0-14	15-64	Mbi 64
Berat	48.66%	51.34%	16.84%	72.78%	10.38%
Dibër	48.47%	51.53%	20.05%	70.91%	9.04%
Durrës	49.11%	50.89%	18.68%	71.62%	9.70%
Elbasan	48.74%	51.26%	18.74%	72.09%	9.17%
Fier	48.38%	51.62%	17.16%	72.38%	10.46%
Gjirokastrë	49.20%	50.80%	13.97%	72.67%	13.36%
Korçë	49.42%	50.58%	15.63%	71.92%	12.45%
Kukës	49.10%	50.90%	19.74%	70.82%	9.43%
Lezhë	48.77%	51.23%	18.77%	71.93%	9.30%
Shkodër	49.09%	50.91%	17.01%	71.71%	11.28%
Tiranë	49.73%	50.27%	17.67%	71.64%	10.69%
Vlorë	49.22%	50.78%	15.64%	73.18%	11.18%

Burimi: Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Tiranë, 2015


### B.1.2. Migrimi i jashtëm në pakësimin e moderuar të popullsisë

Popullsia banuese në Shqipëri është më pak se 3 milion banorë dhe rezulton me rritje negative prej vitit 2001. Ndryshimet në popullsi vijnë si rezultat i shtesës natyrore të popullsisë dhe migracionit neto. Pas Censusit të fundit të Popullsisë dhe Banesave, përlogaritjet e popullsisë janë bazuar në kombinimin e rezultateve të Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011 dhe ngjarjeve demografike (lindje dhe vdekje) që furnizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. INSTAT, duke u bazuar në të dhënat e Censusit të fundit ka kryer projeksionet e Popullsisë 2011-2013 dhe ka vlerësuar numrin e emigrantëve dhe imigrantëve shqiptarë për dy dekadat e ardhshme. Nga këto llogaritje rezulton se numri i emigrantëve shqiptarë për vitin 2014 ishte rreth 46.500, ndërsa numri i imigrantëve që kanë hyrë në Shqipëri ishte rreth 28.500. Migrimi ndërkombëtar vazhdon të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimet demografike të vendit. Mbizotërimi i të larguarve ndaj të ardhurve ka një ndikim të menjëhershëm në numrin e popullsisë. Gjithashtu migrimi i femrave në moshë pune dhe riprodhuese ndikon në treguesit më të rëndësishëm demografikë siç është rënia e lindshmërisë. Rënia e popullsisë është vërejtur edhe gjatë tre viteve në fundit, pavarësisht së ritmi i

rënies është më i ulët. Gjatë periudhës 2012-2014 popullsia u zvogëlua me rreth 6 mijë banorë.

Por, nga ana tjetër, vërehet një rritje e normës së rritjes së popullsisë, edhe pse ky ritëm vazhdon të mbetet negativ: nga -0,12 % në vitin 2012, në -0,10 % në vitin 2014. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së lehtë të shtesës natyrore si pasojë e rritjes së numrit të lindjeve, ndërkohë që numri i vdekjeve ka mbetur në ato nivele. Gjithashtu, në këtë rritje ka ndikuar edhe rritja e migracionit neto, si pasojë e rënies së numrit të emigrantëve, nga 52,3 mijë në vitin 2012, në 46,5 mijë në vitin 2014, si dhe nga rritja e kthimit të emigrantëve.

Figura 2.3. Tregues demografikë, 2012-2014




Burimi: INSTAT, Tiranë, 2015

### B.1.3. Ndikimi i koeficientit të migrimit neto në popullsinë e Shqipërisë

Projeksionet e popullsisë 2012-2013 konfirmojnë mbizotërimin e emigrantëve ndaj imigrantëve në Shqipëri. Megjithatë, vitet e fundit ky raport vjen duke u zbutur. Koeficienti i migracionit tregon numrin e imigrantëve që kthehen apo hyjnë në një vendbanim për 1,000 banorë në një vit të dhënë. Ky tregues erdhi duke rënë nga 11.6 imigrantë për mijë banorë që vlerësohej në vitin 2012, në 9.8 imigrantë për mijë banorë në vitin 2014.

Koeficienti i emigracionit tregon numrin e emigrantëve që largohen nga një vendbanim për 1,000 banorë të atij vendbanimi në një vit të dhënë. Edhe ky tregues erdhi duke rënë, nga 18.0 në 2012, në 16.1 në 2014. Migracioni neto shpreh efektin neto të imigrantëve dhe emigrantëve mbi popullsinë e një vendi. Ky tregues vazhdon të ndikojë negativisht në bilancin e popullsisë së Shqipërisë. Megjithatë, koeficienti i migracionit neto shënoi një rritje të lehtë, nga -6,4 persona për mijë banorë në 2012, në -6,2 persona për mijë banorë në 2014. Kjo rritje e lehtë i atribuohet më së shumti rënies së fluksit të emigrantëve.

Figura 2.4. Dinamikat e migracionit, 2012-2014 (*Migracioni neto = Emigrantë - Emigrantë*)




Burimi: INSTAT, Projeksionet e popullsisë, 2011-2031

#### B.1.4. Ndikimi i strukturës së flukseve migratore në zhvillimet e popullsisë

Ndikimi i karakteristikave të emigrantëve në zhvillimet demografike lidhet me disa rrethana: i) faktin se shumica e tyre janë në moshë të re dhe aktive për punë; ii) mbizotërimin e meshkujve në flukset e reja të emigrimit ndërkombëtar; iii) vazhdimin e ritmeve të larta të emigrimit familjar dhe të fëmijëve. Pjesa dërrmuese e emigrantëve për të dy gjinitë i përket grup-moshës 20-35 vjeç. Në këto moshë ka diferenca të vogla në numër mes gjinive. Rreth moshës 20 vjeç ka një numër më të madh emigrantësh femra se sa meshkuj. Kjo lidhet me faktin se femrat në këtë moshë mund të largohen nga vendi për arsye martesore, duke kryer një martesë me emigrantë, me të huaj ose për bashkim familjar. Prandaj në grup-moshat 25-45 vjeç vihet re një dominim i lehtë i meshkujve në flukset e emigrimit. Një përqindje e lartë emigrantësh janë të mitur, nga 0-5 vjeç. Kjo shpjegohet me faktin se fëmijët largohen nga vendi bashkë me prindërit e tyre. Në emigrimin e të miturve vihet re një mbizotërim i meshkujve në raport me femrat. Kjo dukuri lidhet edhe me raportin e lartë gjinor në lindje përgjatë gjithë viteve të fundit në Shqipëri, ku për çdo 100 femra të lindura kanë lindur rreth 109 meshkuj. Në figurën e mëposhtme paraqitet numri i emigrantëve sipas moshës dhe gjinisë në vitin 2014.

**Figura 2.5. Numri i emigrantëve sipas gjinisë dhe moshës, 2014**




Burimi: INSTAT, Projektionet e popullsisë, 2011-2031

#### **B.1.5. Ndikimi i emigrimit në raportet e varësisë moshore dhe në strukturën e popullsisë**

Në vitin 2014, në popullsinë e Shqipërisë, të rinjtë (0-14 vjeç) zinin 19,7% të popullsisë, popullsia në moshë pune (15-64 vjeç) llogaritej në rreth dy të tretat (68,8%) e popullsisë, ndërsa popullsia mbi 65 vjeç zinte rreth 12 % të popullsisë së vendit. Për shkak të moshës së re të flukseve migratore, pesha që zënë të moshuarit mbi 65 vjeç në popullsinë e përgjithshme të vendit gjatë tre viteve të fundit ka shënuar një prirje rritjeje. Në këtë mënyrë, emigrimi ndërkombëtar, flukset e të cilit vazhdojnë të përfshijnë një popullsi relativisht të re, vazhdon të ndikojë në plakjen e popullsisë, krahas uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë.

Një tregues i strukturës së popullsisë është raporti i varësisë moshore. Varësia moshore shfaqet në dy aspekte: i) varësia e popullsisë së moshuar dhe ii) varësia e popullsisë së re. Raporti i varësisë së të moshuarve llogaritet si raport i popullsisë 65 vjeç e lartë, ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç. Për vitin 2014 ky raport në Shqipëri ishte 17.8% kundrejt 16.8% në vitin 2012. Ky raport po shfaq një tendencë në rritje me kalimin e viteve, e cila dëshmohet nga një peshë në rritje e popullsisë së moshuar ndaj popullsisë në moshë pune. Në këtë prirje ndikon edhe mbizotërimi në flukset migratore i moshave të reja. Raporti i varësisë së të rinjve llogaritet si raport i popullsisë 0-14 vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç. Ky raport për vitin 2014 ishte 27.4% kundrejt 29.8% në vitin 2012. Pra, koeficienti i varësisë së të moshuarve vjen duke u rritur, ndërsa koeficienti i varësisë së të rinjve vjen duke u zvogëluar. Këta dy tregues përbëjnë dy anë të së njëjtës medalje: dukurisë së moshimit të popullsisë. Dhe të dy proceset ndodhin për të njëjtën arsye: mbizotërimin e moshave të reja në flukset e reja migratore.

Figura 2.6. Popullsia sipas tre grup-moshave kryesore dhe raportet e varësisë moshore, 2012-2014



Burimi: Burimi: INSTAT, Projektionet e popullsisë, 2011-2031

## B.2. Korrelacioni midis emigrimit dhe zhvillimit ekonomik

Zhvillimi ekonomik është i lidhur drejtpërdrejtë me proceset migratore. Korrelacioni midis zhvillimit ekonomik dhe emigrimit të jashtëm shfaqet në disa aspekte: i) lidhjet sinergjike midis emigrimit dhe zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik; lidhjet midis emigrimit dhe investimeve, sidomos investimeve të huaja; lidhjet midis emigrimit dhe prirjes për të themeluar ndërmarrje të huaja të përbashkëta; lidhjet midis emigrimit dhe zhvillimit të pabarabartë ekonomik të rajoneve të vendit.

### B.2.1. Zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

Një nga objektivat e Qeverisë shqiptare është zhvillimi i zonave të lira ekonomike ose zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të cilat nxitin zhvillimin ekonomik të vendit dhe kanë një rëndësi të veçantë edhe në zbutjen e problematikave sociale. Në aspektin ekonomik, zonat e zhvillimit teknik dhe ekonomik: i) krijojnë rrethana më të favorshme për zhvillimin ekonomik; ii) nxisin investitorët vendas dhe të huaj për të investuar në Shqipëri; iii) mbështesin partneritetin midis sektorëve publik dhe privat ekonomik në zhvillimin ekonomik; iv) mbështesin zhvillimin e zonave rurale dhe lehtësojnë procesin e urbanizimit. Në aspektin social, zonat e zhvillimit teknik dhe ekonomik: i) krijojnë vende të reja pune; ii) ulin varfërinë; iii) zbusin pabarazinë rajonale ekonomike dhe sociale; iv) përmirësojnë standardet e jetesës. Të gjitha ndikimet e mësipërme dekurajojnë flukset migratore të popullsisë dhe ndihmojnë krijimin e kushteve për një punë dhe jetesë dinjitoze në vend.

## B.2.2. Investimet e Huaja

### B.2.2.1. Investimet e Huaja sipas shteteve

Dërgesat në para të emigrantëve konsiderohen si element përberës i investimeve të huaja direkte. Prezenca e investimeve të huaja në Shqipëri nga pikëpamja e origjinës paraqitet si më poshtë: i) Investimet nga Greqia zinin vendin e parë, me një stok prej 1,07 miliardë Euro në fund të vitit 2013, me një rritje prej 40% në raport me një vit më parë dhe të përqëndruara në fushën e telekomunikacioneve. ii) Investimet nga Kanada zinin vendin e dytë, me një stok prej 797 milionë Euro, me rritje prej 13% në raport me një vit më parë dhe të përqëndruara në fushën e industrisë nxjerrëse të naftës. iii) Investimet nga Austria zinin vendin e tretë, me një stok 378 milionë Euro, por me rënie prej 2.2%, në krahasim me një vit më parë dhe të përqëndruara në shërbime financiare dhe energji. iv) Investimet nga Holanda zinin vendin e katërt, me një stok prej 350 milionë Euro, me rritje 18% me bazë vjetore dhe të përqëndruara kryesisht në energji. v) Investimet nga Turqia zinin vendin e pestë, me një stok 279 milionë Euro dhe rritje 19% me bazë vjetore. Investimet nga Gjermania zinin vendin e gjashtë, me një stok 107 milionë Euro dhe një rritje 16% krahasuar me një vit më parë.

### B.2.2.2. Investimet e Huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik

Nga pikëpamja e thithjes së investimeve të huaja direkte, kryesojnë sektorët e mëposhtëm: i) Transporti dhe komunikimi të cilët kanë stokun më të lartë të investimeve të huaja direkte, me një vlerë prej 785 milionë Euro në fund të vitit 2013; ii) Sektori i dytë më i rëndësishëm është sektori bankar, stoku i investimeve të të cilit është 780 milionë Euro; iii) Sektori i tretë është industria nxjerrëse dhe minierat, me një stok në vlerën 732 milionë euro.

### B.2.2.3. Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte

Për vitin 2014 fluksi i IHD arriti vlerën 878 milionë Euro. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2013 Shqipëria ka thithur më shumë IHD krahasuar me një vit më parë, me një rritje prej 43%, nga 666 milionë EURO në vitin 2012, në 953 milionë Euro në vitin 2013. IHD në vitin 2013 përbënin 9.9 % të GDP. Sektori industrial (prodhimi, industria përpunuese dhe minierat), ishte ndër sektorët kryesor në thithjen e investimeve, me një vlerë të konsiderueshme në fluksin e IHD. Disa industri me intensitet punësimi, siç janë industria e veshjeve dhe këpucëve kanë tërhequr një numër projektesh, por me sasi modeste kapitali. Të tjerë sektorë të rëndësishëm janë sektori i transportit dhe i komunikacionit. Kanada kryesonte për vitin 2013 me një fluks investimesh prej rreth 595 milionë Euro, e ndjekur nga Holanda me një vlerë prej 70 milionë Euro, Italia me rreth 51 milionë Euro dhe Turqia me 51 milionë Euro. Në vitin 2013 u regjistruan 733 subjekte me pronësi të huaj, ndërsa në vitin 2014 u regjistruan 948 subjekte. Për sa i përket subjekteve me pronësi të përbashkët shqiptare-të huaj, numri i tyre për vitin 2013 ishte 281, ndërsa për 2014 ishte 318 subjekte.

### B.2.2.4. Investimet e Huaja Direkte dhe punësimi

Legjislacioni shqiptar<sup>19</sup> detyron që regjistrimi i subjekteve në regjistrin tregtar përbën gjithashtu, regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë administratës tatimore, qendrore e vendore, në skemën e

<sup>19</sup>Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Neni 59, pika 1.

sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës. Në vitin 2014 në vend ishin 4,246 subjekte të kategorisë Punëdhënës me punëmarrës, 281 subjekte të kategorisë i vetëpunësuar me punëmarrës, 864 subjekte të kategorisë i vetëpunësuar i vetëm, dhe 35 subjekte të kategorisë i vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes.<sup>20</sup> Në vitin 2014 ishin rreth 3,5 mijë ndërmarrje me pronarë të huaj, krahasuar me 2,6 mijë ndërmarrje në vitin 2012. Diferenca prej 1,000 ndërmarrjesh tregon tendencën në rritje të investimeve nga të huajt. Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë çdo vit rreth 4 % të ndërmarrjeve në vend. Ndërmarrjet e mëdha të këtij grupi ushtrojnë aktivitet ekonomik kryesisht në prodhim veshjesh e këpucësh, aktivitete bankare, prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike. Qarqet e Tiranës dhe Durrësit tërheqin shumicën e investitorëve të huaj: rreth 81.2 % e ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta përqendrohet në këto qarqe.

### **B.2.3. Rritja ekonomike, mirëqenia dhe flukset migratore**

Rritja reale e PBB është ndër treguesit më të rëndësishëm të llogarive kombëtare. Gjatë vitit 2013 ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej 1.4 %, ndërsa në vitin 2014, rritja ekonomike ishte 1.9 %.<sup>21</sup> PBB për frymë në vitin 2013 arriti në 471 mijë lekë.<sup>22</sup> Ndikimi i rritjes ekonomike në sistemin e mirëqenies dhe për rrjedhojë, edhe në prodhimin e flukseve migratore, lidhet me kontributin e degëve të ekonomisë në PBB dhe në punësim. Gjatë vitit 2013<sup>23</sup> kontributi kryesor në rritjen ekonomike erdhi nga shërbimet (44.7%), bujqësia (19%), ndërtimi (10.5 dhe industria (12.5%).<sup>24</sup> Ndërkohë, kontributi i sektorëve në punësim ishte shpërpjestimor, sidomos në rastin e bujqësisë dhe shërbimeve. Shërbime thithin një pjesë të vogël të forcës së punës të formalizuar, ndërkohë që rezultojnë ndër sektorët me informalitet shumë të lartë. Mungesa e vendeve të punës dhe informaliteti në ekonomi dhe në tregun e punës ushqejnë natyrshëm flukset migratore të shqiptarëve.

### **B.3. Migrimi dhe zhvillimi i tregut të punës**

Flukset migratore janë të lidhura drejtpërsëdrejti me zhvillimet në tregun e punës, sidomos me nivelin e papunësisë dhe të varfërisë, të cilat përbëjnë “ushqimin” kryesor të flukseve të emigrantëve ekonomikë.

#### **B.3.1. Tregu atipik i punës si ushqyes i flukseve migratore**

Sic është përmendur më sipër, popullsia e Shqipërisë ka shfaqur shenja moshimi. Megjithatë, popullsia e Shqipërisë moshohet me ritme më të ulta se popullsia e BE-së. Mosha mesatare e popullsisë rritet me rreth gjashtë muaj në vit.<sup>25</sup>

Në piramidën e popullsisë shtohet popullsia mbi 65 vjeç, ndërsa grup-mosha nën 15 vjeç pakësohet. Gratë dhe vajzat janë rritur më shumë sesa burrat dhe djemtë, rreth 25 përqind, kundrejt 19 përqind. Kjo diferencë në rritjen e popullsisë femërore në moshë pune është një arsye për nivelin më të lartë të papunësisë femërore dhe nivelin më të ulët të punësimit femëror. Nga ana e saj, kjo

<sup>20</sup>QKR, Tiranë, 2015

<sup>21</sup>INSTAT, Tiranë, 2015

<sup>22</sup>ibid

<sup>23</sup>Të dhënat për vitin 2014 nuk janë publikuar ende

<sup>24</sup>INSTAT, Tiranë, 2015

<sup>25</sup> INSTAT, Tiranë, 2015 (Të dhëna të përpunuara)



dukuri priret të feminizojë flukset migratore, duke nxitur ritmet e larta të emigrimit femëror, si një dukuri e emigrimit të shqiptarëve.

Popullsia në moshë pune rritet me ritme më të larta se forca e punës dhe numri i të punësuarve, çka përbën një sfidë për tregun e punës. Gjatë periudhës 2013-2014 forca e punës u pakësua me rreth 31 mijë persona, nga 1,098,000 në 1,067,000.<sup>26</sup>

Rritja e popullsisë në moshë pune, përbën, si rregull, një “dhuratë demografike” për zhvillimin e tregut të punës. Por përvoja tregon se kjo “dhuratë demografike” potenciale është shndërruar në një “risk demografik” real, për arsye të mungesës së hapjes së vendeve të reja të punës për një kohë shumë të gjatë. Rritja e popullsisë rinore e ka përkeqësuar edhe më shumë situatën e punësimit të rinisë. Ndërkohë, rritja e popullsisë mbi moshën 65 vjeç përbën një barrë në rritje për sistemin e mbrojtjes shoqërore, sidomos skemën e pensioneve.

Sinteza e vlerësimeve të ekonomistëve, studiuesve dhe organizatave ndërkombëtare është se tregu i punës në Shqipëri mbetet ende vulnerabël. Disa tipare të këtij vulnerabiliteti kanë filluar të moderohen, por ndikimi i një pjese të tyre ka qenë prezent edhe gjatë vitit 2014. Disa nga aspektet më të dukshme të vulnerabilitetit të tregut të punës janë: i) Mbizotërimi për një kohë të gjatë i vizionit të vjetëruar për politikën e zhvillimit të tregut të punës; ii) Niveli i ulët i punësimit dhe mungesa për një kohë të gjatë e politikave eficiente dhe produktive për rritjen e tij; iii) Vulnerabiliteti i sektorit “modern” dhe mbizotërimi i sektorit të punës në bujqësi e aktivitete të tjera tradicionale, të cilat zënë mbi 50 përqind të numrit të të punësuarve; iv) Produktiviteti i ulët i punës; v) Niveli i lartë i papunësisë dhe nivelet shumë të moderuara të uljes së saj; vi) Shkalla e lartë e përjashtimit nga tregu i punës, sidomos për grupet situacionale të popullsisë: rininë, gratë dhe punëtorët e pakualifikuar; vii) Niveli shumë i lartë i punësimit informal, i cili bashkëjeton me ekonominë informale; viii) Konfuzioni dhe mungesa për një kohë të gjatë e burimeve të besueshme statistikore për njohjen e treguesve dhe prirjeve të tregut të punës, të cilat gjatë vitit 2014 kanë realizuar përmirësime të ndjeshme; ix) Performanca e dobët e institucioneve publike të tregut të punës, sidomos në nivel rajonal e lokal, gjendje prej të cilës këto shërbime filluan të dalin gjatë vitit 2014; x) Vulnerabiliteti i sistemit të arsimit dhe formimit profesional, i cili kishte mbetur në një nivel të prapambetur, joefiçent dhe jonxhtës i punësimit dhe që për këtë arsye i është nënshtruar një rithemelimi të sistemit, përmbajtjes dhe menaxhimit; xi) Buxheti i politikave dhe programeve të nxitjes së punësimit kanë qenë modest dhe për vite të tëra ka ardhur në ulje, për të shënuar një rritje të ndjeshme në vitet 2014 dhe 2015; xii) Mungesa e konkurrencës midis shërbimeve publike dhe shërbimeve private të punësimit, edhe kjo një gjendje që është adresuar e përmirësuar vitet e fundit.

### B.3.2. Tiparet e tregut të punës dhe flukset migratore

Disa nga tiparet e tregut të punës në Shqipëri, të cilat ndikojnë në inkurajimin e flukseve migratore janë:

i) **Niveli i lartë i papunësisë rinore:** Gjatë vitit 2014 papunësia rinore (grup-mosha 15-29 vjeç) ka qenë 32.5%, kundrejt 17.9% të nivelit zyrtar të papunësisë.<sup>27</sup> Papunësia tek të rinjtë lidhet me mungesën e mundësive të reja për punësim në sektorin publik dhe hezitimin e sektorit privat për të

<sup>26</sup> Bilanci i foracve të punës, 2013-2014, INSTAT, Tiranë, 2015

<sup>27</sup> INSTAT, Tiranë, 2015

punësuar moshat e reja.

ii) **Niveli i lartë i papunësisë afatgjatë dhe i dekurajimit jashtë tregut të punës:** Në vitin 2014 numri i të papunëve afatgjatë ishte rreth 12 herë më i madh se numri i të papunëve që përfitonin pagesë papunësie, 82,133 kundrejt 7,395.<sup>28</sup> Kjo tregon se papunësia friksionale dhe strukturore janë në nivele të larta dhe format kryesore të papunësisë në vend.

iii) **Tregu i punës mbetet refraktar e joelastik edhe ndaj të rinjve që shkollohen:** Përfundimi i shkollave të mesme dhe të larta dhe kërkesat në rritje për punësim nga ky kontigjent nuk gjejnë përgjigjen e duhur nga kapacitetet thithëse të tregut të punës. Kjo dukuri rrit numrin e të punësuarve të diplomuar.

iv) **Shpërndarja e pabarabartë e papunësisë:** Nga perspektiva territoriale, papunësia vjen duke rënë nga zona veriore (Dibër, Kukës, Shkodër, Lezhë); në zonën qendrore (Durrës, Korçë, Berat, Elbasan) dhe në zonën jugore (Gjirokastër, Vlorë, Fier).

v) **Papunësia e lartë në fshat e bujqësi:** Nga bujqësia dhe fshati vijnë prurjet më të mëdha në rezervuarin e papunësisë. Bujqësia kontribon me rreth 19 përqind të PBB, por punëson rreth 45 përqind të forcës së punës. Kjo e dhënë dëshmon për një produktivitet të ulët të punës në bujqësi. Produktiviteti i ulët bashkëjeton me informalitetin e lartë: vetëm rreth gjysma e të punësuarve në bujqësi paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore.

### B.3.3. Informaliteti në tregun e punës

Ekonomia dhe puna kanë një shkallë të lartë informaliteti në Shqipëri. Informaliteti i lartë në tregun e punës shpjegohet me disa rrethana: i) niveli i lartë i ekonomisë informale; ii) punëtorët nganjëherë pranojnë të punojnë në sektorin informal të detyruar nga mungesa e alternativave për tu punësuar në sektorin formal; iii) sipërmarrja e konsideron informalitetin si një zgjidhje që ofron një mjedis më të mirë; iv) një pjesë e të punësuarve në sektorin informal nuk u japin shumë rëndësi përfitimeve dhe mbrojtjes sociale që ofrohen përmes instrumenteve formale ligjore dhe institucionale.

Ndër tiparet më të spikatura të informalitetit në tregun e punës mund të vlerësohen: i) Niveli i lartë i informalitetit në sektorin modern, në krahasim me sektorin tradicional, bujqësinë; ii) Diversiteti sektorial i informalitetit, me tendencë rritjeje në ndërtim e shërbime; iii) Pasojat më të ndjeshme të informalitetit të të punësuarit me pagë; iv) Niveli mjaft i ulët i pagave në sektorin informal krahasuar me sektorin formal; v) Diferencimi më i madh i pagave në sektorin informal në krahasim me sektorin formal; vi) Evazion dhe konfuzioni në raportimin dhe pagesën e taksave të punës; vii) Ndikimet kontradiktore të dinamikës së pagës minimale në dinamikën e informalitetit. Tiparet e mësipërme pengojnë ose ngadalësojnë krijimin e një ambjenti nxitës për rritjen e punësimit, rritjen e produktivitetit të punës dhe permirësimin e cilësisë së jetesës së punonjësve informale.

### B.3.4. Ndikimi i punësimit të të huajve në tregun e punës

Numri i të huajve që imigrojnë drejt Shqipërisë për motive punësimi vjen në rritje, ngaqë Shqipëria po bëhet një vend tërheqës për të huajt si edhe nga klima pozitive ndaj biznesit. Me mbështetjen e

<sup>28</sup>INSTAT, Tiranë, 2015

legjislacionit shqiptar,<sup>29</sup> punësimi i shtetasve të huaj në Shqipëri është lehtësuar. Situata e punësimit të të huajve sipas sektorëve të aktiviteteve që ushtrojnë, krahasuar me vitet paraardhës paraqitet si më poshtë:

Për vitin 2012: Janë pajisur me leje pune 2,499 shtetas të huaj dhe janë përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me Leje Pune 180 shtetas të huaj. Janë pajisur me leje për herë të parë 1,830 shtetas të huaj ose 73% e totalit.

Për vitin 2013: Janë pajisur me leje pune 2,958 shtetas të huaj (2,189 leje pune dhe 769 vërtetime punësimi) të dhëna nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Zyrat e Punësimit në varësi të tij.

Për vitin 2014: Janë pajisur me leje pune 3,443 shtetas të huaj (2,054 leje pune + 1,389 vërtetime punësimi) ose 16 % më shumë së një vit më parë.

Rajoni që ka pasur fluksin më të madh të shtetasve të huaj të pajisur me leje pune është Tirana, me rreth 50% të lejeve të punës për vitet 2012 dhe 2013 dhe 41.1 % për vitin 2014.<sup>30</sup>

**Tabela 2.2. Shpërndarja e lejeve të punës së lëshuara për të huajt, sipas Zyrave të Punës**

Shpërndarja e lejeve të punës	2012	2013	2014
DRSHKP -Tiranë	48 %	50 %	41.1%
DPSHKP	20%	13.7 %	13%
DRSHKP- Lezhë	1.3%	7.7 %	2.6%
DRSHKP- Fier	9%	7.7 %	8.6%
DRSHKP-Shkodër	2.6%	2.8%	1.41%
DRSHKP-Durrës	5.1%	5.7%	4.4%
DRSHKP Elbasan	3.3%	6.9%	14%
Total	2499	2189	2054

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, Tiranë, 2015*

Sipas burimeve nga MMSR, vendin e parë e zënë kërkesat për leje pune për kategorinë e punëmarrësve, (1,802 në vitin 2012, 1,888 për vitin 2013 dhe 1,792 për vitin 2014. Në vend të dytë janë kërkesat e të vetëpunësuarve (258 në 2012, 234 në vitin 2013 dhe 177 në vitin 2014 ). Në vend të tretë janë kërkesat nga investitorët.

Sektori më i kërkuar për punësimin e të huajve është ndërtimi (19% në 2012, 25% në 2013 dhe 31% në 2014), i ndjekur nga shërbimet (7% në vitin 2012, 13% më 2013 dhe 17 % në vitin 2014), industria nxjerrëse (12% në vitin 2012, 10% më 2013 dhe 14% në vitin 2014) dhe tregëtia (15% në vitin 2012, 12% më 2013 dhe 9% në vitin 2014).

Sipas shtetësisë, vendin e parë e zënë shtetasit nga vendet jo anëtare të BE-së: turq (19% në 2012, 39.5% në 2013 dhe 52% në 2014), kinezë (7.5% në 2012, 5% në 2013 dhe 12% në 2014) dhe kanadezë (8% në 2012, 7% në 2013 dhe 8 % në 2014).

<sup>29</sup>Ligji Nr.108/2013 datë 28/03/2013 "Për të Huajt" dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 66-70 dhe 74-85 datë 12.02.2014.

<sup>30</sup> Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, Tiranë, 2015

**Tabela 2.3. Lëshimi i lejeve të punës, kategorizuar sipas shteteve**

	2012		2013		2014	
	LP	%	LP	%	LP	%
Turqi	474	19	865	39.5	1068	52
Kinë	188	7.5	112	5	248	12
Kanada	195	8	156	7.1	162	7.8
Indi	17	0.6	37	1.7	54	2.6
Serbi	11	0.4	15	0.6	37	1.8
Egjipt	26	1	47	2.1	32	1.5
<b>Total</b>	<b>2499</b>		<b>2189</b>		<b>2054</b>	

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, Tiranë, 2015*

Të huajt e pajisur me Leje Pune janë më së shumti meshkuj (86.2% në 2012, 88.5% në 2013 dhe 92 % në 2014. Gjatë viteve vitet 2012, 2013 dhe 2014 janë përjashtur nga detyrimi për tu pajisur me leje pune respektivisht 180, 199 dhe 194 persona. Pjesa më e madhe e këtyre përjashtimeve janë në Tiranë (58% në vitet 2012 dhe 2013, 64% në vitin 2014), në Elbasan ( respektivisht 24%, 1.5% dhe 11%) dhe Shkodër (2.7%, 24%, 6%). Sipas shtetësisë, shumica e përjashtimeve janë bërë për shtetas turq (0.5% në 2012, 18% në 2013, 22% në 2014), koreano-jugorë ( 3% në 2013 dhe 14.4% në 2014), kinezë (respektivisht 14%, 9%, 12%), brazilianë (respektivisht 4.5% në 2013 dhe 10% në 2013), indianë (respektivisht 3%, 7%, 8% dhe kanadezë (respektivisht 0.5% në 2012 dhe 5.6% në 2014). Shumica e të përjashtuarve nga ky detyrim janë misionarë fetarë, profesionistë dhe punonjës vullnetarë. Në vitin 2014 ata zinin respektivisht 60.3%, 14% dhe 10.3% të përjashtimeve.<sup>31</sup> Të punësuarit e huaj informale përbënin 10% të të huajve në 2012, 4% në 2013 dhe 1% në 2014.

#### **B.4. Migracioni dhe shëndeti**

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik. Shteti është ofruesi kryesor i shërbimeve shëndetësore, i promovimit të shëndetit, parandalimit, i diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve. Kujdesi shëndetësor ofrohet nga një numër i madh ofruesish publik dhe një numër i kufizuar ofruesish privat. Shërbimi shëndetësor diagnostikues dhe kurues është i organizuar në tre nivele: shërbimi parësor, shërbimi spitalor dytësor dhe spitalor terciar. Sektori i shëndetësisë është duke iu përshtatur ndarjes së re territoriale-administrative të vendit. Popullsia ekonomikisht aktive paguan sigurime shëndetësore, ndërsa fondet e buxhetit të shtetit (të cilat vijnë nga taksimi i përgjithshëm), mbulojnë popullatën joaktive dhe kategoritë në nevojë, duke i dhënë kështu skemës qasjen solidare. Skema e sigurimeve shëndetësore bazohet në modelin e paguesit të vetëm, që është Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, i cili e menaxhon skemën në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor.

<sup>31</sup> Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore MMSR, Tiranë, 2015

Ndikimet kryesore të migrimit në sistemin shëndetësor konstatohen në aspektet e mëposhtme:

i) **Emigrimi i specialistëve të shëndetësisë ka pakësuar burimet njërëzore për sistemin shëndetësor:** Pas viteve 1990 forcat e punës të sektorit të shëndetësisë humbën një numër të konsiderueshëm të burimeve njërëzore, të cilët migruan jashtë vendit. Edhe brenda vendit kanë ndodhur dhe po ndodhin lëvizje nga zonat rurale për ato urbane, duke krijuar një qasje gjithnjë të pabarabartë ndaj kujdesit shëndetësor për popullatën.

ii) **Ndikimi i migrimit të brendshëm në keq-konfigurimin e rrjetit të ofruesve të kujdesit shëndetësor:** Migrimi i madh i brendshëm nga zonat rurale në zonat urbane ka ndikuar në keq-konfigurimin e rrjetit të ofruesve të kujdesit shëndetësor ndaj nevojave të popullsisë. Është e pritshme që emigrantët kryesisht prej zonave rurale, sidomos të thella, të lëvizin drejt zonave urbane. Kjo lëvizje ka ndikuar edhe në ndryshimin e raporteve të mjekëve dhe infermierëve me popullsinë. Numri i mjekëve për banorë është në nivelet më të ulëta në Europë, ndërkohë që numri i personelit infermior është i krahasueshëm edhe me disa vende të Bashkimit Evropian si Spanja, Portugalia etj. Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e profesionistëve të shëndetësisë për banorë.

**Tabela 2.4. Shpërndarja e profesionistëve të shëndetësisë**

Treguesi	/10000 banorë
Viti	2012- 2014
Mjeke në total	12.7
Infermierë në total	42
Mjekë të përgjithshëm	5.4
Infermierë në parësor	22.4

*Burimi: Ministria e Shëndetësisë, Tiranë, 2015*

Në vitin 2014, rreth 72 % e personelit infermior që punonte në zonat rurale ishte me arsim të lartë, 27 % me arsim të mesëm dhe vetëm 1% me kurse 1-2 vjeçare. Megjithëse Shqipëria vazhdon të investojë për formimin dhe edukimin e personelit infermior, një pjesë e tij po largohet nga vendi, të tërhequr nga njohja e diplomës dhe ofertat e punës për paga më të mira në vendet e Europës Perëndimore, si Itali, Gjermani etj.

iii) **Kontributi në financimin e shërbimeve shëndetësore:** Transfertat private nga emigrantët përbëjnë një burim të rëndësishëm për të financuar shpenzimet për kujdesin shëndetësor.

iv) **Ndikimi në aksesin e pabarabartë në shërbimet e kujdesit shëndetësor:** Migrimi nga zonat rurale në ato urbane ka çuar në rritjen e aksesit të asaj popullate në përdorimin dhe shumëllojshmërinë e kujdesit shëndetësor në zonën urbane, krahasuar me mundësinë më të pakët të aksesit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në zonat rurale. Shpërndarja jo e njëtrajtshme e personelit mjekësor sjell pabarazi në aksesin ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Megjithëse popullata gjatë këtyre viteve në zonat urbane është më e madhe se ajo e zonave rurale, nevojitet një shpërndarjeje më e mirë e mjekëve të përgjithshëm. Në disa zona ka rritje të ngarkesës për mjek kundrejt normës së mbulimit të popullatës. Braktisja nga ana e personelit shëndetësor të zonave të vështira rurale si dhe lëvizjet e brendshme të popullsisë vështirësojnë planifikimin e nevojave të

burimeve njerëzore në këtë sektor. Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e mjekëve dhe infermierëve në territorin e vendit, sipas zonave urbano-rurale.

**Tabela 2.5. Shpërndarja e mjekëve dhe infermierëve sipas zonave urbano-rurale**

Zona/Viti	2012	2013	2014
<b>Zona urbane</b>			
Mjekë	850	850	848
Infermierë	2569	2420	2632
<b>Zona rurale</b>			
Mjekë	731	735	747
Infermierë	3962	3936	975

*Burimi: Ministria e Shëndetësisë, Tiranë, 2015*

v) **Rritja e riskut të sëmundshmërisë:** Ndryshimet ekonomiko-sociale e demografike që kanë ndodhur gjatë 25 viteve të fundit, kanë rritur shkallën e rrezikut për importimin dhe përhapjen e sëmundjeve që nuk i hasnim më parë. Rritja e numrit të udhëtimeve jashtë dhe brenda vendit përbëjnë rrezik potencial për importimin dhe përhapjen e tyre. Migrimi i brendshëm ka sjellë ndryshime në mënyrën e jetesës, duke shtuar rreziqe të reja për shëndetin.

vi) **Ndikimi i emigrimit të kthyer në nevojën për mbulesa vaksinale në Shqipëri:** Vaksinimi është një e drejtë themelore e fëmijëve dhe institucionet e kujdesit shëndetësor kanë detyrim tua ofrojnë dhe të krijojnë kushtet që ky shërbim të ofrohet kudo dhe të jetë i sigurt, pavarësisht kushteve ekonomiko-sociale dhe vendbanimit të tyre. Vaksinimi i përgjithshëm kundër sëmundjeve që parandalohen me anë të vaksinimit është vendimtar për të pakësuar vdekshmërinë e foshnjave dhe të fëmijëve. Imunizimi i fëmijëve me vaksinat bazë është një nga ndërhyrjet shëndetësore me efikasitetin më të lartë. Shqipëria ka një program kombëtar të konsoliduar të vaksinimit. Në vendin tonë, kjo mbulesë është mbi 97% për çdo vaksinë të kalendarit kombëtar. Gjatë viteve 2012-2014 janë kthyer në Shqipëri 12,444 fëmijë emigrantëve, (respektivisht 3,484 në 2012, 5,020 në 2013 dhe 3,940 në 2014) të cilët ndjekin programin kombëtar kundër vaksinimit.<sup>32</sup>

vii) **Nevoja për vaksinimin e personave që lëvizin në drejtim të vendeve me rrezikshmëri të sëmundjeve infektive:** Ndryshimet ekonomiko-sociale dhe demografike që kanë ndodhur gjatë këtyre 20 viteve të fundit, rritja e numrit të udhëtimeve dhe shkalla ende e lartë e lëvizjeve migratore përbëjnë rrezik për importimin e sëmundjeve që i kishim eliminuar më parë. Vaksinimi kryhet për çdo udhëtar që udhëton në vende me rrezik për sëmundje infektive, pavarësisht nga koha që do kalojnë në atë vend, pranë Klinikës së Sëmundjeve Infektive në QSUT. Gjatë periudhës 2012-2014 janë vaksinuar 1,700 persona (respektivisht 591 në 2012, 604 në 2013 dhe 505 në 2014).<sup>33</sup>

viii) **Rritja e rrezikut të infektimit me HIV/AIDS:** Shqipëria konsiderohet si vendi me nivelin më të lartë të lëvizjes së popullatës, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, në rajon. Transmetimin e HIV-it e mundëson lëvizshmëria e popullsisë, sidomos migrimi i përkohshëm, pasi situatat me të cilat ndeshen dhe sjelljet e rrezikshme në të cilat individët përfshihen gjatë lëvizjes ose migrimit, rrisin

<sup>32</sup>Ministria e Shëndetësisë, Tiranë, 2015.

<sup>33</sup>Ministria e Shëndetësisë, Tiranë, 2015.

vulnerabilitetin dhe rrezikun ndaj HIV/AIDS. Shqipëria është një vend origjine dhe tranziti i grave që trafikohen për shfrytëzim seksual, dhe marrja e drogave me injektim është në rritje. Të gjithë faktorët e rrezikut që mund të çojnë në një rritje të shpejtë të sëmundjes janë të pranishëm në Shqipëri. Nga përlogaritjet, prevalenca e HIV-it në vendin tonë është 0,02% dhe incidenca 0,003 % (popullata sipas CENSUS të 2011). Ndonëse prevalenca e infeksionit HIV është e ulët, vihet re një tendencë në rritje e numrit të rasteve vitet e fundit. Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria bën pjesë në vendet me prevalencë të ulët të HIV/AIDS-it në popullatën e përgjithshme. Në periudhën 2012-2014 në vendin tonë janë raportuar 297 raste të infektuara me HIV. Niveli më i lartë i hasjes së infeksionit HIV është raportuar në vitin 2013. Në këtë vit rezultojnë 124 persona HIV pozitiv, midis të cilëve 5 fëmijë. Përsa i përket vendit të marrjes së infeksionit HIV, 76 prej tyre mendojnë se e kanë marrë virusin HIV jashtë vendit, kryesisht në Greqi dhe Itali.

Zhvillimet dhe përmirësimet në sistemin shëndetësor gjatë dy viteve të fundit po ndikojnë edhe në dekurajimin e flukseve migratore, duke rritur aksesin e popullsisë në shërbimet e përkujdesit shëndetësor dhe mjekësor, nëpërmjet masave për mbulimin shëndetësor universal; incentivat ndaj personelit mjekësor për mbulimin më të mirë shëndetësor të popullsisë në zonat e thella, malore dhe rurale; uljes së çmimeve dhe rritjes së cilësisë së barnave; harmonizimin e politikave shëndetësore me politikat e linjës, sidomos me politikat e punësimit, sociale, arsimore, ushqimore, bujqësore, të sportit etj.

## **C. KUADRI PER MENAXHIMIN E MIGRACIONIT**

### **C.1. Kuadri ligjor**

#### **C.1.1. Politikat migratore të shprehura në normativën migratore**

Politikat migratore të Republikës së Shqipërisë përfshijnë politikat imigratore dhe emigratore, të shprehur në normativën migratore të vendit, e cila është në përputhje edhe me politikën dhe normativën migratore të BE-së. Politikat migratore synojnë: i) minimizimin e kostove nga migracioni i parregullt; ii) maksimizimin e përfitimeve nga migracioni i rregullt; iii) garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të migrantëve; iv) luftën kundër migracionit të parregulltigjshëm; v) nxitjen e kthimit vullnetar; vi) mbështetjen e lidhjes ndërmjet migrimit dhe zhvillimit të vendit; v) menaxhimin e flukseve imigratore.

Politika migratore shqiptare është e shprehur në Kushtetutë, si kornizë garantuese e të drejtave dhe lirive të të huajve, e rregulluar me anë të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore, si dhe urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse. Legjislacioni shqiptar mbi migracionin përbëhet nga legjislacioni i brendshëm mbi migracionin si dhe kuadri i akteve dy apo shumë palëshe të njohura nga Republika e Shqipërisë.

#### **C.1.2. Ndryshimet në normativat migratore europiane**

Ndryshimi i normativës migratore gjatë viteve të fundit në frymën e legjislacionit të BE-së ka synuar ndërtimin e një platforme të re të politikave migratore, për më shumë partneritet në menaxhimin global të migracionit. Kështu kuadri ligjor shqiptar ka shënuar mjaft përmirësime në aspekt të: i) procedurave të dokumenteve të udhëtimit; ii) vizave; iii) punësimit; iv) qëndrimit; v) bashkimit familjar; vi) luftës kundër migracionit të paligjshëm, përfshirë të miturit e pashoqëruar, hyrjen e paligjshme, qëndrimin e paligjshëm, punësimin e paligjshëm, martesat fiktive, përgjegjësitë e transportuesit; vii) politika e kthimit, ripranimeve dhe riintegritit të qëndrueshëm të të kthyerve; viii) politikës së largimeve, dëbimeve, ndalimeve; ix) politikës së mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve dhe mbrojtjes së të dhënave personale; x) politikës dhe masave represive dhe ankimit; xi) politikës së integritit të imigrantëve, etj.

#### **C.1.3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe instrumentat ndërkombëtare**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në mënyrë direkte garanton çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e të huajve në Republikën e Shqipërisë, si liria e lëvizjes, mos diskriminimin dhe trajtimin e barabartë dhe me dinjitet të të huajve, mbrojtjen e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, ndalimin e dëbimeve kolektive të shtetasve të huaj, të drejtën e proceseve të ankimeve gjyqësore etj.,<sup>34</sup> duke plotësuar kështu kritere të parashikuara në instrumentat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që trajtojnë çështje migratore ratifikuar nga vendi ynë si:

<sup>34</sup>Miratuar me Ligjin Nr 84, date 21.10.1998, botuar në fletoren zyrtare nr. 28, date 07.12.1998, faqe 1073. pika1 neni 16, kreu I, pjesa e dyte; neni 19, kreu I, pjesa e dyte; germa (dh), pika 2, neni 27, kreu I, pjesa e dyte; neni 38, kreu I, pjesa e dyte, neni 39, kreu I, pjesa e dyte, neni 40, kreu I, pjesa e dyte, si dhe klauzolat "kushdo" që gjenden në përmbajtjen e saj.



- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e vitit 1948;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile Politike, e vitit 1966;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, hyrë në fuqi më 4 janar 1969;
- Konventa Europiane për të Drejtat dhe liritë themelore të njeriut, 3 Shtator 1953, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 02.03.2005;
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, miratuar në 18 dhjetor 1990;
- Konventa Nr. 97 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Migracionin për Punësim (E rishikuar) Rishikuar në 1949, hyrë në fuqi në 22 Janar 1952;
- Konventa 143 Për Punonjesit Migrantë (Dispozita Plotësuese), 1975;
- Konventa 181 e ILO Për Agjensitë Private të Punësimit;
- Konventa e Këshillit të Europës “Statusi Ligjor i Punëtorëve Migrantë”.

#### **C.1.4. Përmirësimi i legjislacionit kombëtar mbi migracionin**

Ngjarja më e rëndësishme në përmirësimin e legjislacionit shqiptar për migracionin gjatë viteve 2013- 2014 ishte miratimi i ligjit “Për të huajt” (2013) dhe i ligjit “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” (2014).

Legjislacioni kombëtar për migracionin përbëhet nga aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

- Ligji nr.108/2013 “Për të huajt” shënon një përmirësim të mëtejshëm të normativës migratore mbi të huajt, duke e harmonizuar atë me legjislacionin e BE-së në këtë fushë;
- Ligji Nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” parashikon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” (i ndryshuar) rregullon marrëdhëniet në fushën e emigrimit, për qëllime punësimi ose formimi profesional nëpërmjet punës të shtetasve shqiptarë që largohen nga Republika e Shqipërisë. Zbatimi i këtij ligji mbetet problematik duke shtruar nevojën për një kuadër të ri ligjor që rregullon emigrimin dhe kthimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.
- Ligji nr. 23/2015 “për shërbimin e jashtëm”, ligji konsullor dhe legjislacioni i brendshëm me të cilin rregullohen shërbimet konsullore, vendos bazat normative për funksionimin e shërbimit konsullor dhe shërbimeve bazë që jepen për shtetasit.

Përveç akteve ligjore të sipërcituara, gjatë viteve 2012-2014 pjesë e normativës migratore janë bërë:

- VKM Nr. 513, datë 13.06.2013 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë"
- VKM. Nr. 265, date 7.5.2014, "Për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune apo çertifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare".
- VKM Nr. 76, 77, 70, 69, 68, 67, 66, 85, 84, 83, 82, 81, 80, 79, 78, 74 dhe 75, date 12.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, dhe anulimin e lejes së punës..." ku përfshihen respektivisht të gjithë llojet e punësimeve për shtetasit e huaj.

Pjesë e normativës migratore ajnë edhe urdhra dhe udhëzime miratuar në kuadër të plotësimit të këtij kuadri ligjor:

- Udhëzim mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Udhëzim mbi bashkëpunimin e strukturave të MPB dhe SHISH për procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Urdhër i Brendshëm i Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 643, datë 17.12.2013 "Për marrjen e masave për ripranimin në Shqipëri të të miturve të pashoqëruar, verifikimin dhe fillimin e hetimeve në rastet kur prindërit apo kujdestarët ligjorë nuk përmbushin detyrimet ligjore";
- Urdhër i Përbashkët i Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Social Shtetëror, nr 332/3, datë 07/03.2014 "Mbi marrjen e masave për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen /ripranohen nga vendet e tjera";
- Urdhri i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Nr.83, Datë 06.06.2011, "Për formën, përmbajtjen dhe procedurën e përfitimit të statusit të emigrantit";
- Urdhri i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 84, datë 06.06.2011, "Për formën, përmbajtjen e "Regjistrimit për emigrantët" dhe procedurat e regjistrimit", të ndryshuar";
- Urdhër Nr.147, datë 9.7.2014 "Për deklarin për punësim të shtetasve të BE, Zonës Shengen, shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shtetasve të Republikës së Kosovës dhe shtetasve të Republikës së Serbisë, të përkatësisë etnike shqiptare".

#### C.1.5. Akte dy apo shumëpalëshe të njohura nga Republika e Shqipërisë

Përveç përmirësimit të normativës së brendshme, legjislacioni shqiptar mbi migracionin gjatë viteve 2011-2014 është pasuruar nga nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me vende fqinje dhe të BE-së:

- Marrëveshja për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë. (2014);
- Marrëveshja për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Belgjikës. (2014);

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shtetit të Katarit në lidhje me rregulloren e punësimit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit (2014);
- Marrëveshja e Ripranimit me Rumaninë (2013);
- Marrëveshja e Ripranimit dhe protokolli i Zbatimit me Moldavinë (2013);
- Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim për projektin pilot “Triple Win Migration” me Gjermaninë (2012);
- Marrëveshja e Ripranimit me Republikën Çeke (2012);
- Marrëveshja e Ripranimit me Turqinë (2012);
- Marrëveshja për qarkullimin me kartë identiteti me Malin e Zi (2011) ;
- Marrëveshja për qarkullimin me kartë identiteti me Maqedoninë (2011) ;
- Marrëveshja për shkëmbim të dhënave mbi migracionin e paligjshëm dhe azilin me Austrinë (2013) dhe Britaninë e Madhe (2013) ;
- Protokolli i ripranimit me Francën;
- Marrëveshja dypalëshe në fushën e punës ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (2008).

## C.2. Kuadri institucional

Në vijim paraqitet një përshkrim i shkurtër i aktorëve institucionalë kyç të përfshirë në menaxhimin e migracionit.

### C.2.1. Niveli qeveritar

Në nivel qeveritar nuk ka pasur ndonjë zhvillim lidhur me ngritjen e një strukture koordinuese për çështjet migratore në vend. Struktura të posaçme, në institucione të veçanta shërbejnë si sekretariate për monitorimin e strategjive, të cilat prekin dhe çështje mbi migracionin apo me ndikim mbi migracionin, siç janë Strategjia Antitrafik, Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, Strategjia e Riintegritimit të Shtesave Shqiptarë të Kthyer, etj.

### C.2.2. Niveli institucional

Në nivelin institucional përgjegjësia e institucioneve me menaxhimin e çështjeve migratore ka mbetur e njëjtë si ajo e pasqyruar në Profilin vjetor mbi Migracionin të vitit 2013. E veçanta e përgjegjësiwe institucionale është detajmi i përgjegjësiwe të autoriteteve përgjegjëse për trajtimin të huajve, të bëra me anë të ligjit nr 108/2013 “Për të huajt”.

#### C.2.2.1. Ministria e Punëve të Brendshme

MPB nëpërmjet strukturave, si Policia e Shtetit (Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme Kundër Krimit të Organizuar dhe Kundër Krimeve të Rënda), Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët etj., është përgjegjëse kryesore për: parandalimin dhe luftën e migracionit të parregullt nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve; kontrollit të të huajve në procedurat e aplikimit për vizëhyrëse në Republikën e Shqipërisë, kjo në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të MPJ-së dhe SHISH; kontrollit kufitar mbi kushtet dhe kriteret për të hyrë, qëndruar dhe tranzituar në Republikën e Shqipërisë; pajisjen e të huajve me leje qëndrimi; kontrollin e ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor dhe marrjen e masave të largimit

vullnetar, dëbimin, ndalimin e të huajve të parregullt në territor dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës apo në vendin tranzit nga kanë ardhur; zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit me vendet e tjera; pritjen, intervistimin dhe përzgjedhjen e shtetasve të kthyer në kufi, si dhe informimin e tyre mbi mundësitë e riintegrit në vend; bashkëpunimit rajonale dhe me gjerë në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin e paligjshëm dhe paralajmërimin e hershëm; identifikimin dhe trajtimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të personave në zbatim të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Procedurave Standarde të Veprimit përfshi dhe të miturit e pashoqëruar; për luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të personave, për azilin dhe shtetësinë, etj. Si autoriteti përgjegjës për trajtimin e të huajve që hyjnë, tranzitojnë apo qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, struktura për Kufirin dhe Migracionin në varësi të Policisë së Shtetit është e organizuar në nivel qendror dhe vendor, shtrirë në gjithë territorin e RSH me 7 drejtori rajonale.

#### *C.2.2.2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*

MMSR nëpërmjet Drejtorive në përbërje të saj dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin përkatës, në fushën e zhvillimit dhe monitorimit të politikave shtetërore për emigracionin dhe çështjet e lidhura me të: punësimin, arsimin dhe formimin profesional, dhe imigracionin e punës, marrëdhëniet e punës, etj. Prej vitit 2010, në varësi të Shërbimit Kombëtar të Punësimit funksionojnë Sportelet e Migracionit (SM) të cilat janë ngritur pranë të gjitha Zyrave Vendore të Punësimit. Sportelet e Migracionit janë pjesë e rëndësishme e mekanizmit të mbështetjes për riintegrim. Këto struktura shërbejnë si pikë kyçe në nivel vendor për të mbledhur të dhëna të hollësishme për shtetasit shqiptarë të kthyer, të cilët paraqiten vullnetarisht pranë tyre. Sportelet e Migracionit kryejnë funksionet e mëposhtme: i) Intervistim të shtetasve shqiptarë të kthyer që paraqiten vullnetarisht në sportel; ii) Dhënie informacioni për shërbimet publike dhe ato private, në përputhje me nevojat e identifikuar (kur ekzistojnë); iii) Referim tek shërbimet publike dhe ato private (kur ekzistojnë) si dhe projekte specifike të shoqërisë civile në përputhje me nevojat e tyre.

#### *C.2.2.3. Ministria e Punëve të Jashtme*

MPJ është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së vizave si dhe negocimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit; mbështetjen e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe mbrojtjen të drejtave të tyre, organizimin e diasporës shqiptare, bashkërendimin e veprimeve me strukturat e MB për ripranimin e shtetasve shqiptar, etj. Strukturat e MPJ-se që realizojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e MPJ-se në fushën e migracionit janë:

Drejtoria e Çështjeve Konsullore është struktura përgjegjëse në MPJ për trajtimin e të huajve, hartimin e politikave që hyrjes e qëndrimit të tyre në RSH. Kjo drejtori harton politikat e aktivitetit e shërbimit konsullor, monitoron dhe drejton këtë aktivitet;

MPJ nëpërmjet strukturave të saj realizon ndërveprimin, koordinimin dhe bashkëpunimin me përfaqësitë, institucionet dhe organizmat ndërkombëtare. Ajo i) ndjek, me ndihmën e përfaqësive diplomatike në botë, përditësimin e materialeve mbi historikun e diasporës shqiptare, vendosjen e saj, statusin juridik, gjendjen ekonomike dhe arsimore, jetën kulturore dhe organizimin në shoqata e klube, rolin e saj në jetën politike dhe shoqërore të vendit pritës, personalitetet më të shquara,

mediat në gjuhën shqipe etj; ii) grumbullon, përpunon dhe përgjithëson informacionin me qëllim hartimin e studimeve të përditësuara në vazhdimësi për diasporën në vende të veçanta, për shoqatat dhe organizatat e diasporës; iii) Bashkëpunon me organizma ndërkombëtare si ONM, ILO etj. dhe me sektorët paralelë të të njëjtit nivel të institucioneve shtetërore që në një mënyrë a një tjetër merren me diasporën, si dhe me mediat elektronike dhe shtypin e shkruar në gjuhën shqipe në diasporë dhe në vend; iv) ndjek problemet dhe veprimtaritë e ndryshme kulturore e artistike të diasporës dhe për diasporën në Shqipëri dhe në vendet ku ajo jeton e punon, në funksion të detyrës për krijimin e një imazhi real për shqiptarët dhe Shqipërinë.

#### *C.2.2.4. Ministria e Shëndetësisë*

MSH, si ofruesi kryesor i shërbimeve shëndetësore, i promovimit të shëndetit, parandalimit, diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve është përgjegjëse për sigurimin e aksesit në kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalor sipas skemës që i ofrohet të gjithë popullatës. Ajo mbështet integritet e emigrantëve të kthyer dhe migrantëve të brendshëm në sistemin shëndetësor, sigurimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale. Struktura e Ministrisë së Shëndetësisë që realizon detyrimet dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë në fushën e migracionit është Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor

#### *C.2.2.5. Ministria e Arsimit dhe Sportit*

MAS është përgjegjëse për të kontribuar në integrimin e shtetasve të huaj në Shqipëri në fushën e arsimimit, kulturës dhe shkencës, si dhe për krijimin e kushteve për arsimimin dhe edukimin e emigrantëve shqiptar në vendet ku ata ndodhen, në gjuhën amtare.

#### *C.2.2.6. Instituti i Statistikave*

INSTAT është përgjegjës për grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen dhe publikimin e statistikave në fushën e migracionit. Ky Institut kryen anketime dhe prodhon raporte mbi situatën e migracionit në vend.

#### *C.2.2.7. Aktorë të tjerë institucionalë në fushën e migracionit*

Angazhimi i aktorëve ndërkombëtar në mbështetjen direkt të çështjeve të migracionit në Shqipëri, ka vazhduar në pothuajse të njëjtin intensitet siç gjendet i përshkruar në PZM për vitet vitit 2010, 2013, 2014. Programet e mbështetjes së këtyre aktoreve ndërkombëtarë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për menaxhimin e migracionit në Shqipëri. Legjislacioni, teknologjia e informacionit (Regjistri Elektronik për të Huajt), pajisje dhe teknologji bashkëkohore, trajnime, etj etj, kane qënë fushat e mbështetjes direkt të aktorëve ndërkombëtarë në menaxhimin e migracionit.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin vazhdon të mbetet një nga partnerët strategjikë të Qeverisë Shqiptare në mirëqeverisjen e migracionit, që përfshin si hartimin ashtu dhe zbatimin e politikave migratore në të mirë të migrantëve dhe gjithë shoqërisë shqiptare. Vetë hartimi dhe publikimi i këtij Profili të Zgjeruar mbi Migracionin është pjesë e mbështetjes së vazhduar të ONM-së në Shqipëri.

### **C.3. Kuadri i politikave**

Institucionet përgjegjëse për trajtimin e aspekteve të ndryshme të migracionit në Republikën e Shqipërisë, janë përgjegjëse për zbatimin politikave të veçanta migratore, pjesë përbërëse të politikës së përgjithshme migratore sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore me anë të të cilave është rregulluar politika migratore në Republikën e Shqipërisë.

#### **C.3.1. Politikat migratore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Politikat migratore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë përfshijnë dokumentat e mëposhtme:

i) Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014–2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.818, datë 26.11.2014. Vizioni i strategjisë, i frymëzuar nga objektivi i përgjithshëm i “Evropa 2020” për realizimin e një rritjeje të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, është që brenda vitit 2020 të kemi një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet tek: “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për gjithë femrat dhe meshkujt”. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës. Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi përqendrohet në katër përparësitë strategjike: nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës, ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial dhe fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve. Strategjia shpreh politikat e migracionit të punës në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve informuese dhe këshilluese për emigrimin e rregullt për punësim, përmirësimin e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve për emigrantët, fuqizimin e agjencive private të punësimit, rritjen e bashkëpunimit me vendet e tjera për menaxhimin e emigrimit për punësim nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të punës, njohjen e kualifikimeve profesionale dhe eksperiencës profesionale të fituar jashtë vendit etj., përafrimin e vazhdueshëm të legjislacionit të imigrimit me atë të BE për realizimin e të cilave përmban aktivitete dhe afate konkrete në planin e saj të veprimit.

ii) Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015 dhe Plani i saj i veprimit janë pjesë e politikave kombëtare për migracionin. Vizioni i saj është siguri i një kthimi të qëndrueshëm për emigrantët përmes mbështetjes së procesit të riintegrit, pavarësisht formës së kthimit. Strategjia shënjestron në radhë të parë shtetasit shqiptarë të kthyer në kuadër të Marrëveshjes së Ripranimit KE-Shqipëri dhe marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit që Shqipëria ka nënshkruar me vende të tjera, ose përmes formave të tjera të kthimit të detyruar. Gjithashtu, kjo strategji paracakton mekanizmat që adresojnë edhe nevojat e shtetasve shqiptarë të kthyer vullnetarisht. Plan i saj i veprimit përmban 42 masa të cilat synojnë riintegrimin e të kthyerve.

#### **C.3.2. Politikat migratore të Ministrisë së Punëve të Brendshme**

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2014–2020, miratuar me VKM Nr. 119, datë 05.03.2014, konceptuar për bashkërendim dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë autoriteteve dhe agjencive, të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, me qëllim përsosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të menaxhimit të integruar të kufirit, me synim arritjen

e qëllimit të përbashkët të kufijve të hapur por të kontrolluar dhe të sigurt. Strategjia dhe Plani i Veprimit kundert Trafikimit të Qënieve Njerëzore, 2014-2017, bazohet në katër shtylla: i) ndjekja penale, ii) mbrojtja nga trafikimi i viktimave, iii) parandalimi, iv) bashkërendimi dhe koordinimi i punës midis institucioneve.

### **C.3.3. Politikat migratore të Ministrisë së Punëve të Jashtme**

Politikat dhe shërbimet migratore të MPJ përfshijnë:

- i) Përmirësimin e asistencës për shtetasit në vështirësi ku në fokus të veçantë janë personat në vështirësi ekstreme, duke pasur në fokus të veçantë asistencën për të burgosurit dhe personat nën hetime, dhe organizimin e sistemeve të krizave dhe emergjencave;
- ii) Përmirësimin dhe dixhitalizimin e shërbimeve dhe informacionit për shërbimet konsullore dhe përmirësimin e informacionit të dixhitalizuar në dispozicion të shtetasve;
- iii) Lehtësimin e lëvizjes në vende të huaja;
- iv) Përmirësimin e trajtimit të të huajve në Shqipëri, nëpërmjet garantimit të të drejtave të të huajve kur vijnë në Shqipëri dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera që trajtojnë të huaj dhe lehtësimin të kushteve të ardhjes të të huajve në Shqipëri nëpërmjet heqjes së vizave sezonale dhe përmirësimeve procedurale në dhënien e vizave.

## D. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### D.1. Përfundime

Nga studimi i zhvillimeve të migracionit shqiptar në periudhën 2012- 2014 mund të gjenerohen përfundimet e mëposhtme:

#### ➤ Dinamikat migratore:

Gjatë vitit 2014 nga Shqipëria më shumë u larguan emigrantë shqiptarë (46.500) sesa hynë imigrantë (rreth 28.500). Megjithatë, koeficienti i migracionit neto shënoi një rritje të lehtë, në 2014 si pasojë e rënies së numrit të emigrantëve, nga 52,3 mijë në vitin 2012, në 46,5 mijë në vitin 2014, si dhe nga rritja e kthimit të emigrantëve. Shqipëria vazhdon të prodhojë flukse të emigrimit familjar, emigrimit të grave dhe vajzave, emigrimit të trurit dhe emigrimit të të miturve të pashoqëruar.

Grupet më të mëdha të komunitetit të emigrantëve shqiptarë janë aktualisht emigrantët ekonomikë, pjestarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë dhe studentët.

Gjatë viteve të fundit ritmet e legalizimit të emigrantëve shqiptarë kanë qenë të moderuara për shkak se shumica e tyre kanë qenë legalizuar gjatë dekadës së fundit.

Shqipëria përfaqëson një rast tipik të korrelacionit midis migrimit të brendshëm dhe të jashtëm: migrimi i brendshëm shërben si një trampolinë për migrimin ndërkombëtar.

Shqiptarët vazhdojnë të emigrojnë duke përdorur kanalet e rregullta dhe të parregullta të emigrimit ndërkombëtar.

Ndërkohe që fluksi i emigrimit të shqiptarëve për motive punësimi në mënyrë të parregullt ka shfaqur shenja moderimi, fluksi i shqiptarëve që kërkojnë azil në vendet e BE-së është rritur gjatë viteve të fundit.

Gjatë viteve të fundit është intensifikuar kthimi i emigrantëve. Gjatë vitit 2014 është konstatuar kthim vullnetar i emigrantëve ekonomikë; kthim i detyruar i emigrantëve ekonomikë për shkak të krizës në vendet kryesore pritëse, Greqi dhe Itali; kthim i të miturve të ose jo të shoqëruar nga prindët; kthim i një numri të vogël viktimash të trafikimit. Shumica e kthimeve ka ndodhur për shkak të papunësisë në vendin pritës.

Një pjesë e emigrantëve të kthyer kërkojnë shërbime pranë Sporteleve të Migracionit. Por përqindja e emigrantëve që kërkojnë dhe marrin shërbime mbetet modeste në raport me numrin e të kthyerve.

Shqipëria vazhdon të ketë varësi të lartë nga dërgesat në para të emigrantëve. Gjatë vitit 2014 ndodhi një rritje e lehtë në krahasim me vitin 2013: nga 497 milionë në 592 milionë EURO.

Sinergia midis migrimit dhe zhvillimit është një dukuri e re në emigrimin e shqiptarëve. Politikat dhe shërbimet e sistemit të mirëqenies në Shqipëri nuk arrijnë të mbulojnë nevojat thelbësore të të varfërve. Për këtë arsye, të ardhurat nga emigrimi janë përdorur kryesisht si një faktor konsumi e mbijetese dhe më pak si një burim për financimin e projekteve të investimeve dhe zhvillimit. Kjo



shpjegon vonesën e emigrimit të kthyer dhe sinergjinë e dobët midis migrimit dhe zhvillimit.

Ndikimi ekonomik dhe fiskal i emigrantëve në vendet pritëse vjen në rënie. Kjo ndodh për disa rrethana, ndër të cilat mund të përmendim: rënien e aftësive dhe performancës ekonomike; shpërpjestimin midis të ardhurave të emigrantëve dhe punëtorëve vendas; inercinë e ndikimit të përkatësisë etnike; ashpërsimin e konkurrencës me punëtorët vendas etj.

Gjatë vitit 2014 Shqipëria ka shërbyer si vend pritës kryesisht për imigrantë ekonomikë, studentë, refugjatë dhe azilkërkues. Numri i shtetasve të huaj që qëndrojnë në Shqipëri ka mbetur i pandryshuar në vitin 2014, numri i studentëve të huaj u ul, ndërsa numri i azilkërkuesve u rrit për shkak të iranianëve muxhahidinë si edhe për faktin se Shqipëria njihet ndërkombëtarisht si vend i sigurt dhe pa komplekse raciale, etnike dhe fetare.

Gjatë vitit 2014 pati një rritje të ndjeshme të numrit të shtetasve huaj, të kapur në tentativë për të kaluar tranzit nëpër Shqipëri. Edhe gjatë vitit 2014 Shqipëria vazhdoi të konsiderohej si një vend origjine i emigracionit, si vend që është tentuar të jetë vend tranzit drejt vendeve të Besë dhe si vend destinacioni për imigrantët nga disa vende arabe, të Lindjes së Mesme dhe të Azisë.

#### ➤ Ndikimi i migracionit

Emigrimi ndërkombëtar vazhdon të ndikojë në plakjen e popullsisë së Shqipërisë, krahas uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë, ngaqë flukset migratore vazhdojnë të përfshijnë një popullsi relativisht të re. Megjithatë, popullsia e Shqipërisë po moshohet me ritme më të ulta se popullsia e BE-së. Mosha mesatare e popullsisë rritet me rreth gjashtë muaj në vit.

Përparësia që po u jepet zhvillimit të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, nxitjes së investimeve të huaja direkte dhe mbështetjes së ndërmarrjeve të huaja të përbashkëta pritet të ndihmojë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe dekurajimin e fluksit migrator.

Popullsia në moshë pune rritet me ritme më të larta se forca e punës dhe numri i të punësuarve. Ritmet e rritjes së punësimit nuk kanë mundur të ndjekin ritmet e rritjes së popullsisë, dukuri që përbën një sfidë për tregun e punës.

Tregu i punës në Shqipëri mbetet ende vulnerabël. Disa tipare të këtij vulnerabiliteti janë: niveli i lartë i papunësisë rinore; niveli i lartë i papunësisë afatgjatë; tregu i punës mbetet refraktar e joelastik edhe ndaj të rinjve që shkollohen; shpërndarja e pabarabartë e papunësisë; papunësia e lartë në fshat e bujqësi; informaliteti në tregun e punës etj. Disa tipare kanë filluar të moderohen, por ndikimi i një pjese të tyre ka qenë prezent edhe gjatë vitit 2014.

Shqipëria ka një shkallë shumë të lartë informaliteti në tregun e punës. Disa tipare të informalitetit janë: niveli i lartë i informalitetit në sektorin modern, në krahasim me sektorin tradicional, bujqësinë; diversiteti sektorial i informalitetit, me tendencë rritjeje në ndërtim e shërbime; niveli mjaft i ulët i pagave në sektorin informal krahasuar me sektorin formal; evazioni dhe konfuzioni në raportimin dhe pagesën e taksave të punës etj. Punësimi informal është i lidhur me të ardhurat e ulta dhe varfërinë dhe inkurajon flukset migratore.

Numri i të huajve që imigrojnë drejt Shqipërisë për motive punësimi vjen në rritje, jo vetëm ngaqë

Shqipëria po bëhet një vend tërheqës për të huajt, por dhe si rrjedhojë e mbizotërimit të klimës pozitive ndaj biznesit në përgjithësi dhe sidomos biznesit të huaj.

Zhvillimet dhe përmirësimet në sistemin shëndetësor gjatë dy viteve të fundit ndikojnë edhe në dekurajimin e flukseve migratore, duke rritur aksesin e popullsisë në shërbimet e përkujdesit shëndetësor dhe mjekësor, nëpërmjet masave për mbulimin shëndetësor universal; incentivat ndaj personelit mjekësor për mbulimin më të mirë shëndetësor të popullsisë në zonat e thella, malore dhe rurale; uljes së cmimeve dhe rritjes së cilësisë së barnave; harmonizimin e politikave shëndetësore me politikat e linjës, sidomos me politikat e punësimit, sociale, arsimore, ushqimore, bujqësore, të sportit etj.

## **D.2.Rekomandime**

Në kushtet aktuale, kur: i) emigrimi është venë në qendër të interesit publik, në nivelet kombëtare, europiane dhe globale; ii) Shqipëria ka vazhduar të prodhojë flukse emigrantësh ekonomikë; iii) gjendja e emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse fqinje po vështirësohet për shkak të krizës ekonomike; iv) ritmi i kthimit të tyre nga këto vende po intensifikohet; dhe v) Shqipëria është shndërruar në një vend të sigurtë origjine, por edhe një vend tranziti për imigrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit nga vendet e rajoneve përreth, është e nevojshme që politikat dhe menaxhimi i migracionit në vendin tonë të përmirësohen.

### **D.2.1.Rekomandime për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e sistemit të mirëqenies si kusht për dekurajimin e flukseve migratore.**

1. Punësimi dhe mirëqenia sociale e të gjithë qytetarëve përbën një prioritet programor të qeverisë. Në këtë kontekst, krahas zbatimit të ligjshmërisë dhe forcimit të kuadrit rregullator në zhvillimin ekonomik, tregun e punës dhe sistemin e mirëqenies, vëmendja dhe burimet e zhvillimit duhet të përqëndrohen më shumë në krijimin e vendeve të reja të punës, nxitjen e punësimit dhe reduktimin e papunësisë dhe të varfërisë. Kjo do të krijonte kushtet për reduktimin e flukseve migratore, nëpërmjet dekurajimit të faktorëve shtytës të emigrimit.
2. Duke qenë se migrimi i brendshëm shërben si “trampolinë” për emigrimin e ndërkombëtar duket t’i kushtohet më shumë vëmendje dhe burime harmonizimit të politikave migratore me procesin e urbanizimit, integritit, punësimit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së popullsisë së zhvendosur brenda vendit.
3. Duke u nisur nga fakti se dërgesat në para të emigrantëve janë përdorur kryesisht si mjet konsumi e mbijetese ekonomike, është e nevojshme që të ndërtohen mekanizma institucionale, financiarë, bankarë dhe fiskalë për nxitjen e përdorimit të remitancave si burim investimi e zhvillimi. Forcimi i lidhjes midis migrimit dhe zhvillimit mund të realizohet edhe nëpërmjet harmonizimit të përdorimit të kapitalit financiar të emigrantëve me kapitalin human, social të krijuar gjatë përvojës migratore.
4. Sinergjia midis migrimit dhe zhvillimit mund të mbështetet nga harmonizimi i politikave dhe masave për zhvillimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik me politikat për punësimin e punëtorëve vendas, mbështetjen ndaj emigrantëve të kthyer dhe/ose përdorimin e remitancave të emigrantëve si burim për investim në këto zona.

5. Për të parandaluar dhe dekurajuar moshimin e popullsisë për shkak të mbizotërimit të moshave të reja në flukset migratore, është i nevojshëm dekurajimi i emigrimit të jashtëm të popullsisë në moshë të re, nëpërmjet përmirësimit të kushteve, mundësive, aksesit dhe integritetit të rinjve në formimin profesional, arsimin profesional, arsimin universitar në degë të kërkuara nga tregu dhe në tregun e punës. Është i nevojshëm dhe i mundshëm një harmonizim më i mirë i politikave të punësimit, dekurajimit të flukseve migratore, mbështetjes së emigrantëve të kthyer dhe përdorimit të dërgesave në para të emigrantëve si burim investimi e zhvillimi me masat për nxitjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri. Ky harmonizim mund të bëhet produktiv, sidomos në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe minierave, sektori i tretë më i rëndësishëm i investimeve të huaja, ku Shqipëria ka një forcë pune të kualifikuar, një pjesë e madhe e të cilës ndodhet jashtë tregut të punës. Dekurajimi i fluksve migratore kërkon politika më produktive për uljen e papunësisë rinore, pakësimin e numrit të papunëve afatgjatë, ngushtimin e pabarazive në shpërndarjen territoriale të papunësisë, uljen e papunësisë në zonat rurale dhe bujqësi etj. Kjo mund të realizohet edhe nëpërmjet shtimit të incentivave për sipërmarrësit që punësojnë vajza dhe djem të rinj.

#### **D.2.2.Rekomandimet për përfshirjen e migracionit në politikat sektoriale dhe ndërsektoriale**

6. Problemet aktuale të emigrimit të shqiptarëve si edhe nevoja e lidhjes më të mirë midis emigrimit dhe zhvillimit shtrojnë nevojën e hartimit të një strategjie të re të menaxhimit të migracionit në vend.
7. Shtrohet gjithashtu nevoja e vënies në eficiencë të burimeve ekonomike e financiare për përmirësimin e cilësisë së jetës në vend, si kusht për reduktimin e fluksve migratore.
